



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 134

Tiranë – E martë, 1 tetor 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 25.9.2019	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe qeverive të vendeve të tjera anëtare të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore, mbi marrëveshjet e vendit pritës, për Sekretariatit e Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore.....	11271
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 631, datë 25.9.2019	Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet e peshimit joautomatik” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara	11278
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 524, datë 23.9.2019	Për autorizimin e “Noval Laboratory” për kryerjen e analizave laboratorike të mostrave të marra gjatë kontrollit zyrtar dhe tipin e analizave që është i autorizuar të kryejë.....	11305
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 536, datë 27.9.2019	Për miratimin e planit të menaxhimit të ngjalës evropiane (<i>anguilla anguilla</i>) në Shqipëri, për periudhën 2019–2024.....	11306

**VENDIM****Nr. 629, datë 25.9.2019**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE
HERCEGOVINËS DHE QEVERIVE TË
VENDEVE TË TJERA ANËTARE TË
INICIATIVËS SË GATISHMËRISË DHE
PARANDALIMIT TË FATKEQËSIVE
PËR EVROPËN JUGLINDORE, MBI
MARRËVESHJET E VENDIT PRITËS,
PËR SEKRETARIATIN E INICIATIVËS
SË GATISHMËRISË DHE
PARANDALIMIT TË FATKEQËSIVE
PËR EVROPËN JUGLINDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe qeverive të vendeve të tjera anëtare të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore, mbi marrëveshjet e vendit pritës, për Sekretariatit e Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS DHE
QEVERIVE TË VENDEVE TË TJERA
ANËTARE TË INICIATIVËS SË
GATISHMËRISË DHE PARANDALIMIT TË
FATKEQËSIVE PËR EVROPËN
JUGLINDORE MBI MARRËVESHJET E
VENDIT PRITËS PËR SEKRETARIATIN E
INICIATIVËS SË GATISHMËRISË DHE
PARANDALIMIT TË FATKEQËSIVE PËR
EVROPËN JUGLINDORE**

Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës dhe palët e tjera anëtare të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveritë e Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi, Rumanisë, Republikës së Sllovenisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Turqisë (në vijim të referuara si “Palët e IGFP EJL-së”):

Duke njohur përpjekjet që Palët e IGFP EJL-së investojnë në krijimin e një bashkëpunimi më të afërt rajonal dhe të vendosura për të rritur zotërimin rajonal, nën kujdesin politik të procesit të SEECp-së, në kuadër të mbështetjes së Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal;

Bazuar në angazhimet e ndërmarra në Memorandumin e Mirëkuptimit për kuadrin institucional të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore, të nënshkruar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe nga qeveritë e Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi, Republikës së Serbisë, Republikës së Sllovenisë dhe Republikës së Turqisë në Sarajevë, më 28 nëntor 2013 dhe nga Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës në Sarajevë, më 18 prill 2014 dhe nga Qeveria e Rumanisë në Sarajevë, më 19 nëntor 2015;

Duke rikujtuar se Memorandumi i Mirëkuptimit për kuadrin institucional të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore (2013) përcakton se selia e Sekretariatit të IGFP EJL-së ndodhet në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë;

Duke njohur angazhimet e shprehura të palëve të IGFP EJL-së për të mbështetur zotërimin e plotë



rajonat, i cili do të inkurajonte më tej partnerët ekzistues dhe të rinj për t'u përfshirë në bashkëpunimin politik dhe teknik rajonal në fushën e gatishmërisë dhe parandalimit ndaj fatkeqësive;

Duke dëshiruar që të rregullojnë statusin ligjor, privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për funksionimin dhe realizimin me sukses të misionit të Sekretariatit të IGPF EJL-së.

Kanë rënë dakord si më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

a) **“Këshilli i Ministrave”** nënkupton Këshillin e Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës;

b) **“Ekspert”** nënkupton një person që kryen mision të përkohshëm për Sekretariatin ndryshe nga sa është parashikuar sipas paragrafëve “e” dhe “g” të këtij neni dhe mund të përfshijë personelin e dërguar prej palëve të IGPF EJL-së ose praktikantët;

c) **“Shefi i Sekretariatit”** është personi i emëruar si shef i Sekretariatit të IGPF EJL-së në Sarajevë;

d) **“Vendi Pritës”** është Bosnja dhe Hercegovina;

e) **“Anëtar i personelit të Shërbimit Vendor”** nënkupton punonjësit që ofrojnë shërbime mbështetëse për Sekretariatin, të tillë si administrator i rrjetit të internetit, shofer, punonjës pastrimi;

f) **“Memorandum Mirëkuptimi”** nënkupton Memorandumin e Mirëkuptimit të kuadrit institucional të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive dhe për Evropën Juglindore, të nënshkruar më 28 nëntor 2013, në Sarajevë;

g) **“Zyrtar”** nënkupton një anëtar të personelit të Sekretariatit për të cilin është njoftuar Ministria e Punëve të Jashtme të vendit pritës, i cili kryen detyrat për Sekretariatin me kohë të plotë, të ndryshme nga ato në bazë të paragrafit “e” të këtij neni;

h) **“Ambientet e Sekretariatit”** nënkupton godinën, duke përfshirë tokën e saj ndihmëse, të zënë nga Sekretariati dhe të përdorur vetëm për qëllimet e Sekretariatit, pavarësisht nga pronësia;

i) **“Përfaqësues”** nënkupton përfaqësuesin e autorizuar të Palës së IGPF EJL-së ose partnerë të tjerë të IGPF EJL-së; dhe

j) **“Sekretariat”** nënkupton Sekretariatin e IGPF EJL-së.

Neni 2

Selia

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që të mundësojë Sekretariatin për të kryer detyrat dhe funksionet e tij operationale në mënyrë efektive nëpërmjet Selisë të Sekretariatit.

2. Në përputhje me nenin 7, paragrafin 1, të Memorandumit të Mirëkuptimit, Selia e Sekretariatit ndodhet në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë.

Neni 3

Statusi ligjor

1. Sekretariati do të ketë personalitet juridik dhe zotësinë juridike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të tij, si për të lidhur kontrata, për të marrë dhe disponuar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe për të vendosur procedurat ligjore në përputhje me legjislacionin e vendit pritës.

2. Autoritetet kompetente të vendit pritës do të ndihmojnë Sekretariatin në procedurën e marrjes së dokumenteve përkatëse për rregullimin e statusit juridik të Sekretariatit, në mënyrë që statusi të merret brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Kontributet e lidhura me zyrën nga vendi pritës

1. Këshilli i Ministrave do t'i japë Sekretariatit për kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje, pa asnjë tarifë, lehtësirat e nevojshme, duke përfshirë mjediset e përshtatshme dhe të duhura në Sarajevë për kryerjen efektive të funksioneve të tij.

2. Ambientet, duke përfshirë pajisjet, orëditë dhe shërbimet, do të jenë në dispozicion pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.



Neni 5

Rregulloret e brendshme të Sekretariatit

Sekretariati mund të nxjerrë rregullore të brendshme të nevojshme në lidhje me zbatimin dhe organizimin e funksioneve të tij, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit ose çdo rregullim tjetër të brendshëm të zbatueshëm.

Neni 6

Identiteti vizual

1. Sekretariati mund shfaqë artikuj identiteti vizual të IGPF EJJL-së (p.sh.: flamur, logo), të miratuar nga IGPF EJJL, në ambientet e saj dhe në automjete të përdorura për qëllime zyrtare.

2. Mjetet motorike që i përkasin Sekretariatit kanë të drejtë për targa të regjistruara diplomatike dhe të statusit të duhur.

Neni 7

Liria e operacioneve të Sekretariatit

Vendi pritës do t'i garantojë Sekretariatit një liri të operacioneve.

Neni 8

Paprekshmëria

1. Ambientet e Sekretariatit janë të paprekshme. Autoritetet kompetente të vendit pritës do të kenë të drejtën për të hyrë në ambientet e Sekretariatit, në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre, vetëm me pëlqimin e Shefit të Sekretariatit ose zyrtarëve të Sekretariatit, ose të zyrtarëve të autorizuar në mënyrën e duhur, sipas kushteve të rëna dakord nga ana e tyre.

2. Këshilli i Ministrave do të marrë të gjitha masat për të mbrojtur ambientet Sekretariatit kundër çdo ndërhyrjeje apo dëmi, dhe për të parandaluar dëmtimin e dinjitetit të tij.

3. Regjistrimet dhe arkiva e Sekretariatit, si dhe i gjithë dokumentacioni (duke përfshirë programet kompjuterike dhe fotografi) që i përkasin apo janë në pronësi të tij, janë të paprekshme.

Neni 9

Përfashtimi nga procedurat gjyqësore dhe ekzekutimet

1. Sekretariati do të gëzojë përfashtimin nga procedurat gjyqësore dhe ekzekutimet në vendin pritës, me përfashtim të rasteve:

a) kur organi kompetent i IGPF EJJL-së ka autorizuar heqjen dorë nga imuniteti nga procesi gjyqësor. Heqja e imunitetit nga proceset gjyqësore nuk do të nënkuptojë heqjen dorë në lidhje me ndonjë masë të ekzekutimit ose ndalimit të pronës;

b) kundërpaditë në lidhje të drejtpërdrejtë me procedurën e filluar nga Sekretariati;

c) çdo marrëveshje për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, çdo hua apo transaksion tjetër për të siguruar financim, si dhe çdo marrëdhënie garancie ose dëmshpërblimi në lidhje me ndonjë transaksion të tillë ose detyrim tjetër financiar;

d) Padi civile e filluar nga një palë e tretë për shkak të vdekjes, dëmit material ose lëndimeve personale për shkak të shkeljeve të rregullave të trafikut të mjeteve motorike, nga mjete motorike që i përkasin apo përdoren në emër të Sekretariatit; dhe

e) mosmarrëveshjet e punës.

2. Sekretariati, në lidhje me pronën e tij të luajtshme dhe të paluajtshme, kudo që ndodhet dhe nga kushdo që mbahet në vendin pritës, përfashtohet nga çdo masë e ekzekutimit, duke përfshirë konfiskimin, eliminimin, ngrirjen ose ndonjë formë tjetër të ekzekutimit ose sekuestrimit, ose ndonjë privim tjetër të pasurisë të parashikuar nga ligjet e vendit pritës.

Neni 10

Komunikimi

1. Sekretariatit, në lidhje me komunikimin e tij zyrtar, duhet t'i jepet i njëjti trajtim që është dhënë për misionet diplomatike në vendin pritës.

2. Sekretariati mund të përdorë të gjitha mjetet e duhura të komunikimit. Ai do të ketë të drejtën për të dërguar dhe marrë korrespondencë me anë të korrierëve të identifikuar siç duhet ose në paketa të cilave do t'u jepen të njëjtat privilegje dhe gëzojnë përfashtime si korrierë diplomatikë ose paketa diplomatike.



3. Korrespondenca zyrtare dhe komunikimi tjetër zyrtar i Sekretariatit, kur identifikohet siç duhet, nuk do të censurohet.

Neni 11 Publikimet

Importi dhe eksporti i botimeve për nevojat e Sekretariatit, si dhe materialet e tjera informuese që importon Sekretariati ose eksportet në kuadër të aktiviteteve të tij zyrtare, nuk i nënshtrohen kufizimeve të çdo lloji.

Neni 12 Shërbimet publike

1. Autoritetet kompetente të vendit pritës do të jenë të detyruara që, me kërkesën e Sekretariatit dhe në kushte të drejta, të ofrojnë shërbime publike për Sekretariatit, për të cilat ai ka nevojë në mënyrë që të kryejë funksionet e tij, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shërbimet postës, telefon, energji elektrike, ujë, kanalizim, gaz, shërbime të grumbullimit të mbetjeve dhe mbrojtjen kundër zjarrit.

2. Çmimet për shërbimet publike sipas paragrafit 1 të këtij neni, të cilat nuk i nënshtrohen nenit 4, paragrafi 2, nuk duhet të tejkalojnë çmimet më të ulëta të krahasueshme të miratuara në misionet diplomatike në vendin pritës.

3. Në rast të përfundimit apo marrjes së të dhënave për ndërprerje të shërbimeve të lartpërmendura publike, Sekretariatit do t'i jepet i njëjti prioritet si për misionet diplomatike, për kërkesa të funksioneve të tij zyrtare.

4. Me kërkesën e autoriteteve kompetente të vendit pritës, kryetari i Sekretariatit do të jetë përgjegjës për të siguruar përfaqësuesit e autorizuar në mënyrën e duhur të shoqërive të shërbimeve publike për të kontrolluar, riparuar, mirëmbajtur dhe zhvendosur instalimet në ambientet e Sekretariatit, në kohën e duhur, në kushte që nuk do të ndikojnë në funksionimin e Sekretariatit.

Neni 13 Përfshirja nga detyrimet dhe taksat

1. Sekretariati, fondet e tij, të ardhurat dhe pronat e tjera do të përfshihen nga çdo detyrim dhe taksë e drejtpërdrejtë. Ky përfshirje nuk

zbatohet për tatimet dhe ndarjet buxhetore që konsiderohen taksa të shërbimeve publike të ofruara me çmime fikse, në përputhje me sasinë e shërbimeve të ofruara, të cilat mund të identifikohen, të përshkruara dhe të ndara.

2. Në kushtet e tatimit mbi vlerën e shtuar (në vijim i referuar si "TVSH") të përfshirë në çmime ose të llogaritur veçmas, përjashtimi do të zbatohet vetëm mbi sendet e fituara për përdorimin zyrtar të Sekretariatit, ndërsa mallrat e blera për përdorimin e saj, për të cilat zbatohen përjashtime në përputhje me këtë dispozitë, nuk duhet të shiten, jepen si dhuratë ose privohen në ndonjë mënyrë tjetër, përveç në përputhje me kushtet e rëna dakord me Këshillin e Ministrave.

3. Sekretariati do të përjashtohet nga të gjitha vlerat ose tarifat shtetërore dhe vendore, përveç normave të tarifave ose të llogaritura si çmimet e shërbimeve të kryera realisht.

4. Përjashtimi nga TVSH-ja, i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, si dhe më pas në nenin 17, paragrafi 1, pika "d", dhe në nenin 18, paragrafi 1, pika "d" do të realizohet nëpërmjet të drejtës për rimbursim të TVSH-së.

Neni 14 Përjashtimi nga dogana

Mallrat e importuara apo të eksportuara për qëllim të përdorimit zyrtar nga Sekretariati do të përjashtohen nga pagesa e doganës, tatimeve dhe taksave.

Neni 15 Disponimi i lirë i fondeve dhe liria e biznesit

Sekretariati, për qëllim të përmbushjes së funksioneve të tij, ka të drejtë të marrë, mbajë, konvertojë dhe transferojë të gjitha fondet, monedhat, të hollat dhe vlerat e tjera të transferueshme, dhe t'i disponojë lirisht dhe të kryejë biznes pa kufizime, në përputhje me legjislacionin e vendit pritës.

Neni 16 Sigurimet shoqërore

Shefi i Sekretariatit, zyrtarët dhe ekspertët, të cilët nuk janë qytetarë të vendit pritës apo rezidentë të përhershëm, do të përjashtohen nga pagesa e



kontributeve të detyrueshme në lidhje me çdo lloj të sigurimit shoqëror në vendin pritës.

Neni 17

Shefi i Sekretariatit dhe zyrtarët

1. Shefi i Sekretariatit dhe zyrtarët në vendin pritës gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme në vendin pritës:

a) imunitet nga procesi gjyqësor në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara, si dhe për të gjitha veprimet e kryera prej tyre në cilësinë e tyre zyrtare, edhe pasi të pushojnë së qeni zyrtarë të Sekretariatit;

b) imunitet prej kërkimit dhe konfiskimit të bagazheve të tyre personale;

c) paprekshmëri të dokumenteve zyrtare, të dhënave dhe materialeve të tjera;

d) përjashtim nga taksat, duke përfshirë TVSH-në, kontributet për pagat, shpërblimet dhe kompensimet e paguara atyre nga ana e Sekretariatit për shërbimet e tyre;

e) përjashtim nga kufizimet e emigracionit dhe detyrimi për të regjistruar veten dhe anëtarët e familjeve të tyre që janë pjesëtarë të familjes së tyre përkatëse me të cilët ata jetojnë;

f) të njëjtën mbrojtje dhe lehtësira riatdhesimi për vete dhe anëtarët e familjeve të tyre që janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, siç u janë dhënë zyrtarëve të rangjeve të krahësueshme në misionet diplomatike; dhe

g) të drejtën për të importuar për qëllimin e tyre personal, pa tatim importi dhe taksa ose detyrime të tjera, me kusht që këto tarifa të mos caktohen për ofrimin e shërbimeve publike, si dhe përjashtim nga kufizimet e importit dhe kufizimet e importit dhe eksportit për;

i. orenditë dhe sendet e tyre personale në kohën kur fillojnë detyrën në funksionin e tyre, në një ose më shumë dërgesa individuale; dhe

ii. një mjet motorik çdo katër vjet.

2. Mënyra në të cilën mallrat e importuara do të disponohen, me përjashtim nga pagesa e detyrimeve të importit, do të zbatohet në përputhje me rregulloret për tatimet, taksat dhe shumat e tjera, për cilat kanë të drejtë zyrat e huaja diplomatike dhe konsullore përfaqësuese në vendin pritës.

Neni 18

Ekspertët

Ekspertët do të gëzojnë privilegjet dhe përjashtimet e mëposhtme në vendin pritës:

a) përjashtimi nga procedurat gjyqësore në lidhje me fjalët e folura apo të shkruara, si dhe të gjitha aktet e kryera prej tyre në përmbushjen e funksioneve të tyre zyrtare, edhe pasi të pushojnë së qeni ekspertë të Sekretariatit;

b) përjashtimi nga kontrolli dhe sekuestrimi i bagazheve personale dhe zyrtare;

c) paprekshmëria e dokumentacionit zyrtar, të dhëna dhe materiale të tjera; dhe

d) përjashtimi nga taksat, duke përfshirë TVSH-në, kontributet mbi pagat, përfitimet shtesë dhe dëmshpërblimet që u paguhen atyre nga ana e Sekretariatit për shërbimin e tyre, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm të vendit pritës.

Neni 19

Përfaqësuesit

Përfaqësuesit do të gëzojnë përjashtimet e mëposhtme gjatë periudhës së kryerjes së përgjegjësisë të tyre në vendin pritës, si dhe gjatë qëndrimit të tyre në territorin e vendit pritës:

a) përjashtim nga procedurat gjyqësore në lidhje me fjalët e folura apo të shkruara, si dhe të gjitha aktet e kryera prej tyre në përmbushjen e funksioneve të tyre zyrtare, edhe pasi të pushojnë së qeni përfaqësues;

b) përjashtim nga kontrolli dhe sekuestrimi i bagazheve personale;

c) paprekshmëri e dokumentacionit zyrtar, të dhënave dhe materialeve të tjera; dhe

d) përjashtim nga kufizimet e emigracionit.

Neni 20

Qytetarët e vendit pritës dhe banorët e përhershëm

Shefi i Sekretariatit, zyrtarët dhe ekspertët, të cilët janë shtetas të vendit pritës ose me qëndrim të përhershëm nuk do të kenë të drejtë për privilegjet dhe imunitetet të përmendura në nenin 17, paragrafi 1, pikat “a”, “b”, “c” dhe “d”, të kësaj Marrëveshje.



Neni 21

Stafi vendor i shërbimit

Sekretariati do të ketë të drejtën për të marrë personel të shërbimit vendor në përputhje me legjislacionin e vendit pritës.

Neni 22

Qëllimi i privilegjeve dhe përjashtimet

1. Privilegjet dhe imunitetet sipas kësaj Marrëveshjeje janë dhënë në interes të Sekretariatit dhe jo për përfitime personale të vetë individëve.

2. Qëllimi i tyre është vetëm për të siguruar lirinë e veprimeve të Sekretariatit në të gjitha rrethanat, si dhe pavarësinë e plotë të personave të përmendur në kryerjen e detyrave të tyre për Sekretariatit.

Neni 23

Njoftimi

1. Sekretariati do të njoftojë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të vendit pritës në lidhje me emrat e shefit të Sekretariatit dhe zyrtarëve, si dhe të anëtarëve të familjeve të tyre menjëherë ose brenda maksimumi pesë ditësh pune nga data e mbërritjes së tyre. Sekretariati do të njoftojë përfundimin e mandatit të Kryetarit të Sekretariatit ose të çdo zyrtari, si dhe kur është e nevojshme, faktin që një person pushon së qeni anëtar i familjes së tyre.

2. Shefit të Sekretariatit dhe Zyrtarët, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të cilët nuk janë shtetas ose me banim të përhershëm në vendin pritës, duhet t'u jenë lëshuar kartat e duhura të identitetit nga Ministria e Punëve të Jashtme e vendit pritës.

3. Sekretariati nuk duhet të njoftojë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në lidhje me emrat e Ekspertëve. Ekspertët do t'i nënshtrohen kufizimeve dhe detyrimeve të imigracionit për t'u regjistruar në Shërbimin për Çështjet e të Huajve në Ministrinë e Sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit pritës.

Neni 24

Mosmarrja e përgjegjësisë nga ana e vendit pritës

Vendi pritës nuk do të marrë asnjë përgjegjësi ndërkombëtare për veprimet apo mosveprimet nga ana e Sekretariatit në territorin e tij.

Neni 25

Çështjet e sigurisë

1. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk përjashton të drejtën e Këshillit të Ministrave të vendit pritës për të zbatuar të gjitha masat e duhura të mbrojtjes në interes të sigurisë publike. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të pengojë zbatimin e ligjeve të vendit pritës, të nevojshme për vendosje të shëndetit ose rendit publik.

2. Nëse Këshilli i Ministrave i vendit pritës e çmon të nevojshme zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, dhe sa më shpejt që e lejojnë rrethanat, ai do të lidhet me Sekretariatit për të marrë një vendim të përbashkët mbi masat që mund jenë të nevojshme për të mbrojtur interesat e Sekretariatit.

3. Sekretariati është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet e vendit pritës, në mënyrë që të parandalohet çdo pengesë e sigurisë publike për shkak të një aktiviteti të kryer nga ana e Sekretariatit.

II. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet palëve të IGPF EJL-së.

Neni 27

Ndryshimet

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet nëpërmjet propozimit me shkrim të çdo pale të IGPF EJL-së.

2. Çdo propozim i tillë duhet t'i komunikohet nga Depozitari të gjitha palëve të IGPF EJL-së.



3. Palët e IGPF EJJL-së do të njoftojnë depozitarin sa më shpejt të jetë e mundur për miratimin e tyre të amendamenteve të propozuara.

4. Amendamentet e miratuara me konsensus, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 28 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 28

Hyrja në fuqi dhe zbatimi i përkohshëm

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit pasardhës nga data e marrjes së njoftimit të gjashtë të palëve të IGPF EJJL-së nga depozitari, duke përfshirë vendin pritës, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Për çdo Palë të IGPF EJJL-së që njofton Depozitarin për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, kjo Marrëveshjeje, do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit nga data e marrjes së njoftimit të asaj pale të IGPF EJJL-së nga Depozitari.

3. Kjo marrëveshje do të zbatohet përkohësisht nga data e nënshkrimit të saj, për sa kohë që një Palë e IGPF EJJL-së nuk deklaron në momentin e nënshkrimit të saj që kërkesat e saj të brendshme ligjore nuk lejojnë këtë zbatim të përkohshëm. Për të gjitha këto Palë të IGPF EJJL-së, Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të tyre te Depozitari.

Neni 29

Aderimi

Me hyrjen e saj në fuqi, kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për çdo palë të IGPF EJJL-së që aderon në Memorandumin e Bashkëpunimit në përputhje me nenin 13 të saj. Për palën që aderon, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit te Depozitari.

Neni 30

Kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për aq kohë sa edhe Memorandum i Mirëkuptimit është në fuqi.

2. Këshilli i Ministrave i vendit pritës ka të drejtë të denoncojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar palët me shkrim. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë 6 (gjashtë) muaj nga marrja e këtij njoftimi.

3. Çdo Palë e IGPF EJJL-së mund të denoncojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar me shkrim depozitarin. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të pushojë së qeni në fuqi për atë Palë të IGPF EJJL-së, ditën e parë të muajit, nga data e pranimit të njoftimit nga Depozitari.

4. Denoncimi nga Memorandum i Mirëkuptimit, në përputhje me nenin 15, paragrafin 2, duhet të konsiderohet si denoncim i kësaj Marrëveshjeje. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të ndërpritet për palën e IGPF EJJL-së në fjalë, nga data kur denoncimi i Memorandumit të Mirëkuptimit do të hyjë në fuqi për atë palë të IGPF EJJL-së.

Neni 31

Depozitari

1. Këshilli i Ministrave i Bosnjë dhe Hercegovinës do të veprojë si depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

2. Originali i kësaj Marrëveshjeje do të depozitohet pranë depozitarit, i cili do t'u mundësojë palëve të IGPF EJJL-së dhe Sekretariatit kopje të vërtetuara të saj.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e autorizuar sipas rregullave nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Ankara, më 4 prill 2018, në një original në gjuhën angleze.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Bullgarisë

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Sllovenisë

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë

.....



Bërë në Sarajevë, më 4 korrik 2018
Në emër të Qeverisë së Republikës së Kroacisë

.....

Në emër të Qeverisë së Malit të Zi

.....

Në emër të Qeverisë së Rumanisë

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Serbisë

.....

Bërë në Tiranë, më 20 shtator 2018
Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

.....

Bërë në Sarajevë, më 19 nëntor 2018
Në emër të Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe
Hercegovinës

.....

VENDIM

Nr. 631, datë 25.9.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR INSTRUMENTET E PESHIMIT JOAUTOMATIK” DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimorë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet e peshimit joautomatik” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara, sipas tekstit që i

bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën bashkëlidhur këtij vendimi, shërbejnë si dokumente referencë për prezumimin e konformitetit të instrumenteve të peshimit joautomatik, me kërkesat thelbësore të objektivave të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Çdo instrument i vendosur në treg para hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe në përputhje me vendimin nr. 77, datë 30.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumenteve të peshimit joautomatik’”, nuk do të pengohet të bëhet i disponueshëm në treg pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Edhe certifikatat e lëshuara në përputhje me vendimin nr. 77, datë 30.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumenteve të peshimit joautomatik’”, janë të vlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Vendimi nr. 77, datë 30.1.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumenteve të peshimit joautomatik’”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

¹Ky vendim është përafshuar pjesërisht me direktivën 2014/31/EU, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të BE-së, të datës 26 shkurt 2014, mbi harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare lidhur me vendosjen në dispozicion në treg të instrumenteve joautomatike, numri CELEX 32014L0031, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 96, datë 29.3.2014, faqe 107–148.



RREGULLI TEKNIK
“PËR INSTRUMENTET E PESHIMIT
JOAUTOMATIK” DHE PËRCAKTIMI I
LISTËS SË STANDARDEVE TË
HARMONIZUARA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Ky rregull teknik (këtu e në vijim referuar si “Rregulli”), përcakton kërkesat që duhet të përmbushin instrumentet e peshimit joautomatik (këtu e në vijim referuar si “instrumentet”), për ofrimin e një sigurie më të lartë të mbrojtjes së interesave ekonomike, duke garantuar funksionimin e tregut të brendshëm.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Për qëllime të këtij rregulli dallohen kategoritë e mëposhtme të përdorimit të instrumenteve të peshimit joautomatik, për:

- a) Përcaktimin e masës për transaksione tregtare;
- b) Përcaktimin e masës për llogaritjen e taksës doganore, të tarifës, të taksës, të bonusit, të gjobës, të shpërblimit, të dëmshpërblimit ose për lloje të tjera pagesash;
- c) Përcaktimin e masës për zbatimin e ligjeve, të rregulloreve ose për aktvlerësimin e ekspertit të dhënë në gjyq;
- ç) Përcaktimin e masës në praktikën e mjekimit për peshimin e të sëmurit, me qëllim monitorimin, diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor;
- d) Përcaktimin e masës për përgatitjen e ilaçeve, sipas recetës në farmaci, si dhe përcaktimin e masës në analizat që kryhen në laboratorët mjekësorë dhe farmaceutikë;
- dh) Përcaktimin e çmimit në bazë të masës për qëllimin e shitjes së drejtpërdrejtë ndaj publikut dhe të përgatitjes së parapaketimeve;
- e) Të gjitha zbatimet e tjera përveç atyre të renditura në shkronjat “a” deri “dh”, të këtij neni.

Neni 3
Përkufizimet

Në kuptim të këtij rregulli, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) **“Instrument peshimi”**, një instrument matës që shërben për të përcaktuar masën e një trupi, duke përdorur veprimin e gravitetit në atë trup. Instrumenti peshues mund të shërbejë, gjithashtu, për të përcaktuar madhësi të tjera që lidhen me masën, si sasi të, parametrat ose karakteristikat.

b) **“Instrument peshues joautomatik (këtu e në vijim ‘Instrumenti’)”**, një instrument peshimi që kërkon ndërhyrjen e operatorit gjatë peshimit.

c) **“Bërje e disponueshme e produktit në treg”**, çdo furnizim i instrumentit në treg për shpërndarje, konsum ose përdorim të tij gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.

ç) **“Vendosje në treg”**, vënia në dispozicion, për herë të parë, e një instrumenti në tregun e Republikës së Shqipërisë.

d) **“Prodhues”**, çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon një instrument ose ka një instrument të dizenuar ose të prodhuar dhe e vendos atë në treg në emrin ose markën e tij tregtare.

dh) **“Përfaqësues i autorizuar”**, çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i cili ka akt përfaqësimi nga një prodhues për të vepruar në emër të tij për detyra specifike, për detyrimet e prodhuesit që parashikohen në këtë rregull dhe në legjislacionin në fuqi.

e) **“Importues”**, çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i cili vendos në tregun e Republikës së Shqipërisë një instrument nga një vend i huaj.

ë) **“Shpërndarës”**, çdo person fizik ose juridik, i përfshirë në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit ose importuesit, i cili bën të disponueshëm instrumentin në treg.

f) **“Operator ekonomik”**, prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi ose shpërndarësi.

g) **“Specifikim teknik”**, dokumenti ku përshkruhen kërkesat teknike që duhet të përmbushen nga një instrument.

gj) **“Standard i harmonizuar shqiptar”**, një standard shqiptar, që transpozon një standard të harmonizuar evropian, në mbështetje të këtij



rregulli, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, në bashkërendim me ministritë përgjegjëse dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në Fletoren Zyrtare.

h) **“Akreditim”**, dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.

i) **“Organizëm kombëtar i akreditimit”**, organi që kryen akreditimin me autoritetin e dhënë nga ligji, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për akreditimin.

j) **“Vlerësim i konformitetit”**, procesi që provon nëse janë plotësuar kërkesat themelore të këtij rregulli në lidhje me një instrument.

k) **“Organ i vlerësimit të konformitetit”**, një organ që kryen aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, duke përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.

l) **“Kthim i produktit”**, çdo masë për kthimin mbrapsht të një instrumenti, që është bërë ndërkohë i disponueshëm të përdoruesi i fundit.

ll) **“Ndalim i tregtimit”**, çdo masë për të parandaluar instrumentin, në zinxhirin e furnizimit, nga bërja e disponueshme e tij në treg.

m) **“Markimi CE”**, markimi, me të cilin prodhuesi tregon se instrumenti është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

n) **“Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut”**, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

Neni 4

Bërja e disponueshme në treg dhe/ose vënia në shërbim

1. Instrumentet bëhen të disponueshme në tregun shqiptar dhe/ose vihen në shërbim vetëm nëse janë në përputhje me këtë rregull.

2. Instrumentet nuk mund të vihen në shërbim për përdorimet e referuara në shkronjat “a” deri në

“dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, pa plotësuar kërkesat e këtij rregulli.

3. Për instrumentet e vendosura në shërbim, për përdorimet e referuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, duhet të zbatohen masa që sigurojnë përputhjen me kërkesat e këtij rregulli.

Neni 5

Kërkesat thelbësore

1. Instrumentet e përdorura ose të destinuara për përdorimet e listuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, të këtij rregulli (këtu e në vijim referuar si: “Kërkesat thelbësore”).

2. Kur instrumenti përfshin ose është i lidhur me pajisje që nuk përdoren ose nuk synojnë të përdoren për përdorimet e listuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, këto pajisje nuk janë subjekt i këtyre kërkesave thelbësore.

Neni 6

Lëvizja e lirë e instrumenteve

1. Në territorin shqiptar nuk ndalohet bërja e disponueshme në treg e instrumentit që është në përputhje me këtë rregull.

2. Në territorin shqiptar nuk ndalohet vënia në shërbim për përdorimet e referuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, të instrumenteve që plotësojnë kërkesat e këtij rregulli.

KREU II

DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË

Neni 7

Detyrimet e prodhuesit

1. Kur prodhuesi vendos në treg instrumente me qëllim të përdorimit sipas shkronjave “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, ai siguron se ato janë projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I.

2. Për instrumentet e destinuar për t’u përdorur për aplikimet e renditura, sipas shkronjave “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, prodhuesi



harton dokumentacionin teknik të referuar në shtojcën II, të këtij rregulli dhe kryen ose kërkon kryerjen e procedurës së vlerësimit të konformitetit, sipas parashikimeve të nenit 14, të këtij rregulli.

3. Kur nga procedura e vlerësimit të konformitetit është demonstruar përputhshmëria e instrumentit për t'u përdorur për kërkesat e renditura, sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, prodhuesi harton deklaratën EU të konformitetit dhe fikson markimin CE dhe markimin metrologjik suplementar.

4. Për instrumentet e destinuara për t'u përdorur për aplikimet e renditura, sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, prodhuesi mban dokumentacionin teknik dhe deklaratën EU të konformitetit për 10 vjet pasi instrumentet janë vendosur në treg.

5. Prodhuesi siguron se zbatohen procedurat e nevojshme që prodhimi në seri të mbetet në konformitet me këtë rregull. Ndryshimet në projektimin ose karakteristikat e instrumentit dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara shqiptare, standardet ndërkombëtare ose kombëtare apo në specifikimet e tjera teknike sipas të cilave është deklaruar konformiteti i instrumentit, duhet të merren në konsideratë.

6. Kur prodhuesi dyshon se instrumenti, i destinuar për t'u përdorur, sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, mund të paraqesë rrezik, kryen teste të mostrave të instrumenteve të bëra të disponueshme në treg, heton dhe, nëse është e nevojshme, mban një regjistër ankesash për instrumentet jo në konformitet dhe ato të kthyera nga përdoruesi i fundit, si dhe mban të informuar shpërndarësin për çdo monitorim të tillë.

7. Prodhuesi siguron që instrumentet e vendosura në treg prej tij të kenë të shënuar tipin, numrin serial ose element tjetër që mundëson identifikimin e tij, siç përcaktohet në shtojcën III, të këtij rregulli.

8. Për instrumentet që janë të destinuara për t'u përdorur, sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, prodhuesi vendos mbishkrimet e përcaktuara në pikën 1, të shtojcës III, të këtij rregulli.

9. Për instrumentet që nuk janë të destinuara të përdoren sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, prodhuesit vendosin

mbishkrimet e përcaktuara në pikën 2, të shtojcës III, të këtij rregulli.

10. Kur instrumenti që është destinuar për t'u përdorur, sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, përfshin ose është i lidhur me pajisje që nuk përdoren ose nuk kanë për qëllim të përdoren për këto aplikime, prodhuesi i vendos secilës prej këtyre pajisjeve simbolin e përdorimit të kufizuar, siç parashikohet në nenin 19, dhe në pikën 3, të shtojcës III, të këtij rregulli.

11. Prodhuesi vendos në instrument emrin e tij, emrin e regjistruar tregtar ose markën tregtare dhe adresën postare në të cilën mund të kontaktohet. Adresa duhet të tregojë një pikë të vetme në të cilën mund të kontaktohet prodhuesi. Informacioni mbi adresën duhet të jetë në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e fundit dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

12. Prodhuesi siguron që instrumenti i destinuar për t'u përdorur, sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, shoqërohet me udhëzime për përdorimin dhe nga informacion në gjuhën shqipe. Udhëzimet dhe informacionet, si dhe etiketimi duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të lexueshme.

13. Prodhuesi që konsideron ose ka arsye për të besuar se instrumenti që ka vendosur në treg nuk është në përputhje me këtë rregull, ndërmerr menjëherë masat e nevojshme korrigjuese për të sjellë instrumentin në përputhshmëri ose, sipas rastit, të ndalojë tregtimin ose ta kthejë atë nga përdoruesi i fundit. Për më tepër, kur instrumenti paraqet rrezik, prodhuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke i dhënë hollësitë, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

14. Me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, prodhuesi i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, në letër ose në formë elektronike, në shqip ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme, për të demonstruar përputhshmërinë e instrumentit me këtë rregull. Prodhuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga instrumenti i vendosur në treg prej tij.



Neni 8

Detyrimet e përfaqësuesve të autorizuar

1. Prodhuesi, me një akt përfaqësimi, mund të caktojë një përfaqësues të autorizuar. Detyrimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 7, të këtij rregulli, dhe detyrimi për të hartuar dokumentacionin teknik të referuar në pikën 2, të nenit 7, të këtij rregulli, nuk mund të jenë pjesë e aktit të përfaqësimit.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit të lëshuar nga prodhuesi. Akti i përfaqësimit duhet të lejojë përfaqësuesin e autorizuar të kryejë të paktën detyrimet, si më poshtë vijon:

a) Të mbajë deklaraten EU të konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturave të mbikëqyrjes së tregut, për 10 vjet pas vënies në treg të instrumentit;

b) T'i sigurojë strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në rast të një kërkesë të arsyetuar nga ana e saj, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për demonstrimin e konformitetit të instrumentit;

c) Të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas kërkesës së bërë nga ana e saj, për marrjen e masave për eliminimin e rreziqeve të shfaqura nga instrumenti, për të cilin i është lëshuar akti i përfaqësimit

Neni 9

Detyrimet e importuesit

1. Importuesi vendos në tregun shqiptar vetëm instrumente të cilat janë në përputhje me këtë rregull dhe me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

2. Para vendosjes në treg të një instrumenti të destinuar për t'u përdorur, sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, sigurohet që:

a) Prodhuesi ka kryer procedurën e vlerësimit të konformitetit të referuar në nenin 14, të këtij rregulli, dhe ka përgatitur dokumentacionin teknik;

b) Instrumenti të ketë markimin CE dhe markimin metrologjik suplementar dhe të shoqërohet me dokumentet e kërkuara;

c) Prodhuesi ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 7 dhe 11, të nenit 7, të këtij rregulli.

3. Kur importuesi konsideron ose ka arsye të besojë se instrumenti i destinuar për t'u përdorur, sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore, ai nuk duhet ta vendosë në treg derisa ta sjellë në konformitet. Kur instrumenti paraqet rrezik, importuesi informon prodhuesin dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Para se të vendoset në treg instrumenti që nuk ka për qëllim të përdoret, sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, importuesi duhet të sigurojë që prodhuesi është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikat 7 dhe 11, të nenit 7, të këtij rregulli.

5. Importuesi vendos në instrument emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare ku mund të kontaktohet. Kur kjo kërkon që të hapet paketimi, ky informacion mund të jepet në paketim dhe në një dokument që shoqëron instrumentin. Të dhënat e kontaktit duhet të jenë në gjuhën shqipe ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e fundit dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

6. Importuesi siguron që instrumenti, i cili është i destinuar të përdoret, sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, shoqërohet me udhëzime dhe informacion në gjuhën shqipe.

7. Importuesi siguron që gjatë kohës që instrumenti i destinuar të përdoret sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e ruajtjes ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të këtij rregulli.

8. Kur konsiderohet e përshtatshme, në lidhje me rreziqet e paraqitura në një instrument që synohet të përdoret sipas shkronjave "a" deri në "dh", të nenit 2, të këtij rregulli, importuesi duhet të kryejë testimin e mostrave të instrumenteve të bëra të disponueshme në treg, të hetojë dhe, nëse është e nevojshme, të mbajë një regjistër të ankesave, të instrumenteve që nuk përputhen dhe atyre të kthyera nga përdoruesi i fundit, duke mbajtur të informuar shpërndarësit për çdo monitorim të tillë.

9. Importuesi që konsideron ose ka arsye të besojë se një instrument që ka vendosur në treg nuk është në përputhje me këtë rregull, merr menjëherë masat korrigjuese të nevojshme për ta sjellë atë instrument në përputhshmëri, të ndalojë tregtimin ose ta kthejë atë nga përdoruesi i fundit,



nëse është e nevojshme. Kur instrumenti paraqet rrezik, importuesi duhet të informojë menjëherë strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke dhënë detaje, në veçanti, të mospërmbushjes dhe të masave korrigjuese të marra.

10. Për instrumentet të cilët janë të destinuara të përdoren sipas shkronjave “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, importuesi duhet që, për 10 vjet pas vendosjes së instrumentit në treg, të mbajë një kopje të deklaratës EU të konformitetit në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut dhe të sigurojë që dokumentacioni teknik të vihet në dispozicion të këtyre autoriteteve, sipas kërkesës.

11. Importuesi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, në letër ose në formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të instrumentit në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të kuptueshme lehtësisht nga përdoruesit e fundit, siç përcaktohen nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për të eliminuar rreziqet e shfaqura nga instrumenti i vendosur në treg prej tij.

Neni 10

Detyrimet e shpërndarësit

1. Kur një instrument bëhet i disponueshëm në treg, shpërndarësi duhet të veprojë me kujdesin e duhur në lidhje me respektimin e kërkesave të këtij rregulli.

2. Përpara bërjes së disponueshëm në treg të instrumentit të synuar për t'u përdorur sipas shkronjave “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, shpërndarësi verifikon që:

a) instrumenti mban markimin CE dhe markimin metrologjik suplementar;

b) instrumenti shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar, udhëzimet dhe informacionin për sigurinë në gjuhën shqipe;

c) prodhuesi dhe importuesi kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në pikat 7 dhe 11, të nenit 7, si dhe pikën 5, të nenit 9, të këtij rregulli.

3. Kur shpërndarësi konsideron ose ka arsye të besojë që instrumenti i synuar për t'u përdorur për aplikimet e renditura në shkronjat “a” deri në “dh”,

të nenit 2, të këtij rregulli, nuk e bën të disponueshëm instrumentin në treg deri sa të sillet në konformitet. Kur instrumenti paraqet rrezik, shpërndarësi duhet të informojë prodhuesin ose importuesin për këtë qëllim, si dhe strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Përpara se të bëhet i disponueshëm në treg, instrumenti që nuk ka për qëllim të përdoret për aplikimet e renditura në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, shpërndarësi verifikon që prodhuesi dhe importuesit janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikat 7 dhe 11, të nenit 7, si dhe në pikën 5, të nenit 9, të këtij rregulli.

5. Shpërndarësi siguron që gjatë kohës që instrumenti i synuar për t'u përdorur për aplikimet e renditura në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e ruajtjes ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të këtij rregulli.

6. Shpërndarësi që konsideron ose ka arsye të besojë se një instrument që ka vendosur në treg nuk është në përputhje me këtë rregull, duhet të sigurojë që të merren masat korrigjuese të nevojshme për ta sjellë atë instrument në konformitet, të ndalojë tregtimin ose ta kthejë atë nga përdoruesi i fundit, nëse është e nevojshme. Kur instrumenti paraqet rrezik, shpërndarësi duhet të informojë menjëherë strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke dhënë detaje, në veçanti, për mospërputhshmërinë dhe për masat korrigjuese të ndërmarra.

7. Shpërndarësi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, në letër ose në formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të instrumentit. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për të eliminuar rreziqet e shfaqura nga instrumenti i bërë i disponueshëm në treg prej tij.

Neni 11

Rastet në të cilat detyrimet e prodhuesit zbatohen për importuesit dhe shpërndarësit

Importuesi ose shpërndarësi konsiderohet prodhues për qëllime të këtij rregulli dhe i nënshtrohet detyrimeve të prodhuesit sipas nenit 7,



të këtij rregulli, kur ai vendos një instrument në treg nën emrin ose markën e tij tregtare ose e modifikon instrumentin e vendosur tashmë në treg, në mënyrë të tillë që të ndikojë në përputhshmërinë e saj me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull.

Neni 12

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Për instrumentet të cilat janë të destinuara të përdoren sipas këtij rregulli, operatorët ekonomikë, sipas kërkesës së strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, identifikojnë:

a) Çdo operator ekonomik i cili i ka furnizuar ata me instrumente;

b) Çdo operator ekonomik të cilin ata e kanë furnizuar me instrumente.

2. Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, për 10 vjet pasi janë furnizuar me instrumentin dhe për 10 vjet pasi kanë furnizuar me instrumentin.

KREU III

KONFORMITETI I INSTRUMENTEVE

Neni 13

Prezumimi i konformitetit të instrumenteve

Instrumentet që janë në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, prezumohen se janë në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën 1, të këtij rregulli, të mbuluara nga ato standarde ose pjesë të tyre.

Neni 14

Procedurat e vlerësimit të konformitetit

1. Vlerësimi i konformitetit të instrumenteve me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, të këtij rregulli, mund të përcaktohet me secilën nga procedurat e vlerësimit të konformitetit të mëposhtme të përzgjedhura nga prodhuesi:

a) Moduli B, siç përcaktohet në pikën 1, të shtojcës II, pasuar nga moduli D, siç përcaktohet në pikën 2, në shtojcën II, ose nga moduli F, siç përcaktohet në pikën 4, të shtojcës II.

Megjithatë, moduli B nuk do të jetë i detyrueshëm për instrumentet që nuk përdorin pajisje elektronike dhe pajisje matëse të ngarkesës, të cilat nuk përdorin një sustë për të balancuar ngarkesën. Për ato instrumente të cilat nuk i nënshtrohen modulit B, do të zbatohet moduli D1, siç përcaktohet në pikën 3, të shtojcës II, ose moduli F1, siç përcaktohet në pikën 5, të shtojcës II;

b) Moduli G, siç përcaktohet në pikën 6, të shtojcës II.

2. Dokumentet dhe korrespondenca lidhur me procedurat e vlerësimit të konformitetit, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, hartohen në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të pranuar nga autoriteti miratues, në përputhje me nenin 21, të këtij rregulli.

Neni 15

Deklarata EU e konformitetit

1. Deklarata EU e konformitetit provon se është treguar përmbushja e kërkesave thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, të këtij rregulli.

2. Deklarata EU e konformitetit hartohet sipas formës së përcaktuar në shtojcën IV, të këtij rregulli. Ajo përmban elementet e specifikuar në modulet përkatëse të shtojcës II, të këtij rregulli, dhe përditësohet vazhdimisht. Deklarata EU e konformitetit përkthehet në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të kërkuar nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

3. Kur instrumenti është objekt i zbatimit të më shumë se një akti ligjor apo nënligor, që kërkon hartimin e deklaratës EU të konformitetit, hartohet një deklaratë EU e konformitetit e vetme. Deklarata duhet të përmbajë identifikimin e akteve ligjore të zbatueshme, duke përfshirë referencat e tyre të botimit.

4. Me hartimin e deklaratës EU të konformitetit, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e instrumentit me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull.

Neni 16

Markimi i konformitetit

Konformiteti i instrumentit që do të përdoret sipas aplikimeve të renditura në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 2, të këtij rregulli, tregohet nga



prania e markimit CE në instrument dhe shënimit shtesë metrologjik, siç përcaktohet në nenin 17, të këtij rregulli.

Neni 17

Parimet e përgjithshme të markimit CE dhe markimit metrologjik suplementar

1. Markimi CE i nënshtrohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

2. Markimi metrologjik suplementar duhet të përbëhet nga shkronja e madhe “M” dhe dy shifrat e fundit të vitit të fiksimit të tij, të rrethuar nga një drejtkëndësh. Lartësia e drejtkëndëshit duhet të jetë e barabartë me lartësinë e markimit CE.

3. Parimet e përgjithshme, të përcaktuara në legjislacionin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore për markimin CE, zbatohen edhe për markimin metrologjik suplementar.

Neni 18

Rregullat dhe kushtet për vendosjen e markës CE, markimit metrologjik suplementar dhe shenjat e tjera

1. Markimi CE dhe markimi metrologjik suplementar duhet të vendosen në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në instrument ose në pllakën e tij të të dhënave.

2. Markimi CE dhe markimi metrologjik suplementar vendosen para se instrumenti të vendoset në treg.

3. Markimi metrologjik suplementar duhet të ndjekë menjëherë markimin CE.

4. Markimi CE dhe markimi metrologjik suplementar pasohen nga numri/at identifikues i/të organit ose organeve të miratuara të përfshira në fazën e kontrollit të prodhimit, siç përcaktohet në shtojcën II, të këtij rregulli. Numri identifikues i organit të miratuar vendoset nga vetë organizmi ose, sipas udhëzimeve të tij, nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

5. Markimi CE, markimi metrologjik suplementar dhe numri identifikues i organit të miratuar mund të pasohen nga çdo shenjë tjetër që tregon një rrezik apo përdorim të veçantë.

6. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në bashkëpunim me autoritetet doganore, sigurojnë aplikimin korrekt të regjimit që rregullon markimin CE dhe ndërmarrin veprimet e duhura në rast të përdorimit të papërshtatshëm të këtij markimi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 19

Simboli i përdorimit të kufizuar

Simboli i përmendur në pikën 10, të nenit 7, dhe specifikuar në pikën 3, të shtojcës III, të këtij rregulli, vendoset në pajisje në një formë të dukshme dhe të paheqshme.

KREU IV

MIRATIMI I ORGANEVE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

Neni 20

Miratimi i organeve të vlerësimit të konformitetit

1. Procedura e miratimit të organeve të autorizuar për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit të palëve të treta, sipas këtij rregulli, është ajo e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

2. Në përcaktimet në vijim të këtij rregulli, termi “organ” nënkupton një organizëm të autorizuar evropian ose një organ të miratuar shqiptar, i cili është miratuar sipas pikës 1, të këtij neni, për çdo rast.

Neni 21

Autoriteti miratues

1. Ministri përgjegjës për tregtinë vepron si autoritet miratimi për organet e vlerësimit të konformitetit, në kuptim të këtij rregulli.

2. Ministri përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, vepron si autoritet miratues, i ngarkuar me detyrë për krijimin dhe realizimin e procedurave të nevojshme për vlerësimin dhe njoftimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe monitorimin e organeve të



miratuara, përfshirë pajtueshmërinë me nenin 25, të këtij rregulli.

Neni 22

Detyrimi për informim i autoritetit miratues

Ministria përgjegjëse për tregtinë publikon në faqen zyrtare të internetit dhe mban të përditësuar listën e organeve të miratuara me numrat e tyre të identifikimit, fushat për të cilat janë miratuar, periudhën e vlefshmërisë dhe çdo ndryshim të tyre.

Neni 23

Kërkesat për organet e miratuara

1. Për qëllim miratimi, një organ i vlerësimit të konformitetit duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në pikat 2 deri në 15, të këtij neni.

2. Organi i vlerësimit të konformitetit krijohet dhe ka personalitet juridik, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Organi i vlerësimit të konformitetit është një organ, palë e tretë, e pavarur nga organizata ose instrumenti që vlerëson.

Organi që i përket një shoqate biznesi ose federate profesionale që përfaqëson sipërmarrjet e përfshira në projektim, prodhim, ofrim, montim, përdorim ose mirëmbajtje të pajisjeve që vlerëson, me kushtin që të tregohet pavarësia dhe mungesa e një konflikti interesi, mund të konsiderohet një organ i tillë.

4. Organi i vlerësimit të konformitetit, niveli i tij drejtues dhe stafi përgjegjës për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit nuk do të jetë projektuesi, prodhuesi, furnizuesi, instaluesi, blerësi, pronari, përdoruesi ose mirëmbajtësi i instrumenteve që ata vlerësojnë, as përfaqësuesi i njëres prej këtyre palëve. Kjo nuk pengon përdorimin e instrumenteve të vlerësuara që janë të nevojshme për veprimtaritë e organit të vlerësimit të konformitetit ose të përdorimit të këtyre instrumenteve për qëllime personale.

1.5. Organi i vlerësimit të konformitetit, niveli i tij drejtues dhe stafi përgjegjës për të kryer detyra të vlerësimit të konformitetit nuk përfshihen direkt në projektimin, prodhimin ose ndërtimin, tregtimin, instalimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e këtyre instrumenteve ose nuk përfaqëson palët e përfshira në këto veprimtari. Ata nuk përfshihen në veprimtari që mund të jetë në konflikt me

pavarësinë e gjykimit të tyre ose integritetin në lidhje me veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit për të cilat janë njoftuar. Kjo vlen në veçanti për shërbimet e konsulencës. Organet e vlerësimit të konformitetit sigurohen që veprimtaritë e degëve ose të nënkontraktorëve të tyre të mos prekin konfidencialitetin, objektivitetin ose paanshmërinë e veprimtarive të tyre të vlerësimit të konformitetit.

6. Organet e vlerësimit të konformitetit dhe stafi i tyre kryejnë veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit me shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencën e kërkuar teknike në fushën specifike dhe çlirohen nga çdo presion dhe shtysë, sidomos financiare, që mund të ndikojë gjykimin e tyre ose rezultatet e veprimtarive të tyre të vlerësimit të konformitetit, sidomos në lidhje me personat ose grupet e personave që kanë interes në rezultatet e këtyre veprimtarive.

7. Organi i vlerësimit të konformitetit është i aftë të kryejë të gjitha detyrat e vlerësimit të konformitetit që i caktohen nga shtojca II, e këtij rregulli, dhe në lidhje me të cilat është miratuar.

8. Gjithmonë dhe për çdo procedurë të vlerësimit të konformitetit dhe çdo lloj ose kategori të instrumenteve në lidhje me të cilat është miratuar, organi i vlerësimit të konformitetit do të ketë në dispozicion:

a) Stafin e nevojshëm me njohuri teknike dhe përvojë të mjaftueshme dhe të duhur për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit;

b) Përsëkrimet e procedurave, në përputhje me të cilat është kryer vlerësimi i konformitetit, duke siguruar transparencën dhe aftësinë e riprodhimit të këtyre procedurave. Ato do të përmbajnë politika dhe procedura të duhura që dallojnë ndërmjet detyrave që kryen si organ i njoftuar dhe veprimtarive të tjera;

c) Procedurat e nevojshme për kryerjen e veprimtarive që marrin parasysh madhësinë e një sipërmarrjeje, sektorin ku vepron, strukturën, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së instrumentit në fjalë dhe masën ose natyrën seri të procesit të prodhimit.

9. Organi i vlerësimit të konformitetit ka të gjitha mjetet e nevojshme për të kryer detyrat teknike dhe administrative që lidhen me veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit në mënyrën e duhur dhe ka akses në të gjitha pajisjet ose shërbimet e nevojshme.



10. Staf i përgjegjës, për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit, duhet të ketë:

a) Trajnim të qëndrueshëm teknik dhe profesional që mbulon të gjitha veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit në lidhje me të cilat është miratuar organi i vlerësimit të konformitetit;

b) Njohuri të kënaqshme për kërkesat e vlerësimeve që kryejnë dhe autoritet të mjaftueshëm për të kryer këto vlerësime;

c) Njohuri të mjaftueshme dhe aftësi për të kuptuar kërkesat thelbësore, standardet e harmonizuara të zbatueshme dhe dispozitat përkatëse të legjislacionit harmonizues të Bashkimit Evropian dhe të legjislacionit kombëtar;

ç) Aftësi për të hartuar certifikata, të dhëna dhe raporte që tregojnë se vlerësimi është kryer.

11. Garantohet paanshmëria e organeve të vlerësimit të konformitetit, nivelit të lartë drejtues të tyre dhe stafit përgjegjës për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit.

12. Shpërblimi i nivelit të lartë drejtues dhe i stafit përgjegjës, për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit të një organi vlerësimi të konformitetit, nuk varet nga numri i vlerësimeve të kryera apo nga rezultatet e këtyre vlerësimeve.

13. Organet e vlerësimit të konformitetit përdorin mbulimin me siguracion, përveçse kur ky mbulohet nga ministria përgjegjëse për tregtinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose, vetë ministria është direkt përgjegjëse për vlerësimin e konformitetit.

14. Staf i një organi vlerësimi të konformitetit respekton sekretin profesional në lidhje me të gjithë informacionin e marrë për të kryer detyrat e tyre, sipas shtojcës II, të këtij rregulli, ose çdo dispozitë të legjislacionit kombëtar që i jep fuqi, përveçse në lidhje me autoritetet kompetente ku kryhen veprimtaritë e tij. Të drejtat e pronësisë mbrohen.

15. Organet e vlerësimit të konformitetit marrin pjesë ose sigurohen që stafi i tyre përgjegjës, për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit, të informohet për veprimtaritë përkatëse të standardizimit.

Neni 24

Prezumimi i konformitetit të organeve

Kur organi i vlerësimit të konformitetit plotëson kriteret e përcaktuara në standardet e harmonizuara shqiptare ose pjesë të tyre, referencat e të cilave

janë publikuar në Fletoren Zyrtare, do të prezumohet se është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 23, të këtij rregulli, për sa kohë që standardet e aplikueshme të harmonizuara i mbulojnë këto kërkesa.

Neni 25

Degët dhe nënkontraktimi nga organet e miratuara

1. Kur një organ i miratuar nënkontraktin detyra specifike që lidhen me vlerësimin e konformitetit ose i drejtohet një dege të saj për kryerjen e tyre, ajo duhet të sigurojë që nënkontraktori ose dega të plotësojë kërkesat e përcaktuara në nenin 23, të këtij rregulli, dhe duhet të informojë autoritetin miratues përkatësisht.

2. Organet e miratuara marrin përgjegjësi të plotë për detyrat e kryera nga nënkontraktorët ose degët e tyre, kudo që ato janë themeluar.

3. Aktivitetet mund të nënkontraktohen ose të kryhen nga një degë vetëm me marrëveshje me klientin.

4. Organet e miratuara duhet të mbajnë në dispozicion të autoritetit miratues dokumentet përkatëse në lidhje me vlerësimin e kualifikimeve të nënkontraktuesit ose degës dhe punën e kryer nga ata në shtojcën II, të këtij rregulli.

Neni 26

Aplikimi për miratim

Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të paraqesë një kërkesë për miratim tek autoriteti miratues në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 27

Ndryshime në miratim

1. Kur ministri përgjegjës ka dyshime ose informohet se një organ i miratuar nuk i përmbush më kërkesat e miratimit, ose nuk përmbush më detyrimet e tij, atëherë ai, sipas rastit dhe në varësi të shkallës së mospërmbushjes së kërkesave ose detyrimeve, pezullon ose anulon miratimin.

2. Në rast pezullimi ose anulimi të miratimit, ose kur organi i miratuar ka pushuar veprimtarinë e tij,



ministri përgjegjës merr masat e duhura për të siguruar që dosjet t'i kalojnë një organi tjetër të miratuar ose, sipas rastit, të mbahen në dispozicion të ministrit ose strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

KREU V

MBIKËQYRJA E TREGUT DHE KONTROLLI I INSTRUMENTEVE QË HYJNË NË TREG

Neni 28

Detyrimet operacionale të organeve të miratuara

1. Organet e miratuara duhet të kryejnë vlerësimet e konformitetit në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit, të parashikuara në shtojcën II, të këtij rregulli.

2. Vlerësimet e konformitetit duhet të kryhen në mënyrë proporcionale, duke shmangur ngarkesat e panevojshme për operatorët ekonomikë. Organet e vlerësimit të konformitetit kryejnë aktivitetet e tyre, duke marrë parasysh madhësinë e një ndërmarrjeje, sektorin në të cilin vepron, strukturën e tij, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë instrumentale në fjalë dhe natyrën masive ose serike të procesit të prodhimit. Megjithatë, ata duhet të respektojnë shkallën e ashpërsisë dhe nivelin e mbrojtjes së kërkuar për pajtueshmërinë e instrumentit me këtë rregull teknik.

3. Kur një organ i miratuar zbulon se kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, të këtij rregulli, ose standardet përkatëse shqiptare të harmonizuara ose specifikimet e tjera teknike nuk janë plotësuar nga një prodhues, ai duhet të kërkojë që prodhuesi të marrë masat e duhura korrigjuese dhe nuk i lëshon certifikatën e konformitetit.

4. Kur, gjatë monitorimit të konformitetit pas lëshimit të certifikatës, një organ i miratuar konstaton se një instrument nuk është më në përputhje me kërkesat, ai duhet të kërkojë nga prodhuesi të marrë masat e duhura korrigjuese dhe duhet të pezullojë ose të tërheqë certifikatën nëse është e nevojshme.

5. Kur nuk ndërmerren masa korrigjuese ose ato nuk kanë efektin e kërkuar, organi duhet të kufizojë, të pezullojë ose të tërheqë certifikatat, sipas rastit.

Neni 29

Ankimi kundër vendimeve të organeve të miratuara

Organet e miratuara duhet të kenë të rregulluar procedurën e ankimimit ndaj vendimeve të tyre. Organi i miratuar informon ministrinë në lidhje me çfarëdo ankese të pranuar dhe mënyrën se si ajo është zgjidhur.

Neni 30

Detyrim i informacionit nga organet e miratuara

1. Organet e miratuara duhet të informojnë autoritetin miratues për:

a) Çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje të një certifikate;

b) Çdo rrethanë që ndikon në fushëveprimin ose kushtet e miratimit;

c) Çdo kërkesë për informacion që kanë marrë nga strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut lidhur me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit;

ç) Sipas kërkesës, aktivitetet e vlerësimit të konformitetit të kryera brenda fushës për të cilën janë miratuar dhe çdo aktiviteti tjetër të kryer, duke përfshirë aktivitetet ndërkufitare dhe nënkontraktimin.

2. Organet e miratuara duhet të sigurojnë organet e tjera të miratuara sipas këtij rregulli teknik që kryejnë aktivitete të ngjashme të vlerësimit të konformitetit që mbulojnë të njëjtat instrumente, me informacionet përkatëse për çështjet që kanë të bëjnë me rezultatet negative dhe, sipas kërkesës, të vlerësimit pozitiv të vlerësimit të konformitetit.

Neni 31

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i instrumenteve që hyjnë në treg

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i instrumenteve që hyjnë në treg bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 32

Procedura për trajtimin e instrumenteve që paraqesin rrezik në nivel kombëtar

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut ka arsye të mjaftueshme për të besuar që një instrument, objekt i këtij rregulli, paraqet rrezik për aspektet e mbrojtjes së interesit publik që mbulon ky rregull, kryen një vlerësim të përputhjes së instrumentit në fjalë me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull. Operatorët përkatës ekonomikë bashkëpunojnë sipas nevojës me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për këtë qëllim.

2. Kur gjatë vlerësimit të parashikuar në pikën 1, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut konstaton se instrumenti nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë rregull, pa vonesë i kërkon operatorit ekonomik përkatës që të marrë masat e duhura korrigjuese për ta sjellë instrumentin në përputhje me këto kërkesa, për ta ndaluar tregtimin, ose për ta kthyer brenda një kohe të arsyeshme në raport me natyrën e riskut.

3. Strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut duhet të informojnë organin përkatës në përputhje me rrethanat.

4. Veprimet korrigjuese të përmendura në pikën 2, të këtij neni, merren në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

5. Operatori ekonomik siguron marrjen e të gjitha masave të duhura korrigjuese në lidhje me instrumentet që ka bërë të disponueshme në treg.

6. Kur operatori ekonomik nuk merr masat e duhura korrigjuese, brenda periudhës së referuar në pikën 2, të këtij neni, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr masat e duhura të përkohshme për të ndaluar ose kufizuar bërjen e disponueshme në treg të instrumentit, për të ndaluar tregtimin ose për kthimin e tij nga përdoruesi i fundit.

Neni 33

Instrumentet në përputhje me këtë rregull që paraqesin rrezik

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, pas vlerësimit të bërë sipas pikave 1, 2 dhe 3, të nenit 32, të këtij rregulli, konstaton se edhe pse instrumenti është në përputhje me këtë rregull ai

paraqet rrezik në aspektet e mbrojtjes së interesit publik, i kërkon operatorit përkatës ekonomik marrjen e masave të duhura për të siguruar që instrumenti në fjalë kur të vendoset në treg të mos paraqesë rrezik, të ndalojë tregtimin ose ta kthejë atë nga përdoruesi i fundit brenda një periudhe të arsyeshme, në përpjesëtim me natyrën e rrezikut që paraqitet.

2. Operatori ekonomik siguron që të ndërmerren veprime korrigjuese në lidhje me të gjitha instrumentet në fjalë që ai ka bërë të disponueshëm në treg.

Neni 34

Mospërputhja formale

1. Pa përjashtuar parashikimet e nenit 32, të këtij rregulli, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut i kërkon operatorit përkatës ekonomik të sjellë instrumentin në përputhje, kur konstaton një nga rastet e mëposhtme:

a) Markimi CE është fiksuar në shkelje të nenit 18, të këtij rregulli;

b) Markimi CE ose markimi metrologjik suplementar nuk është fiksuar;

c) Mbishkrimet e parashikuara në pikën 7, të nenit 7, të këtij rregulli, nuk janë fiksuar ose janë vendosur në kundërshtim me këtë parashikim;

ç) Numri i identifikimit i organit të miratuar, kur ky organ është i përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit, është vendosur në kundërshtim me nenin 18, të këtij rregulli, ose nuk është vendosur;

d) Deklarata EU e konformitetit nuk është hartuar;

dh) Deklarata EU e konformitetit nuk është hartuar me saktësi;

e) Dokumentacioni teknik ose nuk është në dispozicion ose nuk është i plotë;

ë) Informacioni i përmendur në nenet 7, pika 11, ose 9, pika 5, të këtij rregulli, mungon, është i rremë ose i paplotë;

f) Çdo kërkesë tjetër administrative e parashikuar në nenet 7 ose 9, të këtij rregulli nuk është përmbushur.

2. Kur mospërputhja formale vazhdon, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat e duhura për të kufizuar ose parandaluar bërjen të disponueshëm të instrumentit në treg ose siguron që të ndalohet tregtimi apo të kthehet instrumenti nga tregu.



Neni 35

Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e kërkesave të këtij rregulli nga operatorët ekonomikë trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

SHTOJCA I KËRKESAT THEMELORE

Terminologjia e përdorur është ajo e Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore.

Vëzhgim paraprak

Kur një instrument përfshin ose është e lidhur me më shumë se një pajisje treguese ose shtypëse, e përdorur për aplikimet e listuara në pikat “a” deri në “f”, të nenit 2, ato pajisje që përsërisin rezultatet e operimit të peshimit dhe të cilat nuk mund të ndikojnë në saktësinë e funksionimit të instrumentit, nuk i nënshtrohet kërkesave thelbësore nëse rezultatet e peshimit janë të shtypura ose të regjistruara në mënyrë korrekte dhe të përherëshme nga një pjesë e instrumentit që plotëson kërkesat thelbësore dhe rezultatet janë të arritshme për të dy palët e përfshira nga matja.

Megjithatë, në rastin e instrumenteve të përdorura për shitje të drejtpërdrejtë në publik, pajisjet e ekranit dhe të printimit për shitësin dhe klientin duhet të përmbushin kërkesat thelbësore.

Kërkesat metrologjike**1. Njësiti e masës**

Njësiti e masës së përdorur janë njësiti ligjore brenda kuptimit të Direktivës së Këshillit 80/181/KEE, të datës 20 dhjetor 1979, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me njësiti e matjes.

Në varësi të përmbushjes së këtij kushti, lejohen njësiti e mëposhtme:

- a) Njësiti SI: kilogram, mikrogram, miligram, gram, ton;
- b) Njësi imperiale: *troy ounce*, nëse peshon metalet e çmuara;
- c) Njësi tjetër jo-SI: karat metrik, nëse peshon gurë të çmuar.

Për instrumentet që përdorin njësinë imperiale të masës të përmendur më lart, kërkesat thelbësore relevante të specifikuara më poshtë do të konvertohen në atë njësi, duke përdorur interpolation të thjeshtë.

2. Klasa e saktësisë

2.1 Klasat e saktësisë në vijim janë përcaktuar si më poshtë:

- a) I Speciale
- b) II E lartë
- c) III Mesatare
- d) IIII E zakonshme

Specifikimet për këto klasa janë dhënë në tabelën 1.

Tabela 1

Klasat e saktësisë				
Klasa	Intervali i shkallës së verifikimit (e)	Kapaciteti minimal (min)	Numri i intervaleve të shkallës së verifikimit $n = ((Max) / (e))$	
		vlera minimale	vlera minimale	vlera maksimale
I	$0.001 \text{ g} \leq e$	100 e	50 000	—
II	$0.001 \text{ g} \leq e \leq 0.05 \text{ g}$	20 e	100	100 000
	$0.1 \text{ g} \leq e$	50 e	5 000	100 000
III	$0.1 \text{ g} \leq e \leq 2 \text{ g}$	20 e	100	10 000
	$5 \text{ g} \leq e$	20 e	500	10 000
IIII	$5 \text{ g} \leq e$	10 e	100	1 000



2.2 Ndarjet e shkallës

2.2.1 Ndarja reale e shkallës (d) dhe ndarja verifikuese e shkallës (e) është në formën:

$1 \times 10k$, $2 \times 10k$, ose $5 \times 10k$ njësi të masës, ku k është një numër i plotë ose zero.

2.2.2 Për të gjitha instrumentet e ndryshme nga ato me pajisje ndihmëse: $d = e$

2.2.3 Për instrumentet me pajisje treguese ndihmëse zbatohen kushtet e mëposhtme:

$$e = 1 \times 10 \text{ kg};$$

$$d < e \leq 10 d.$$

përveç instrumenteve të klasës I me $d < 10^{-4} \text{ g}$, për të cilat $e = 10^{-3} \text{ g}$.

3. Klasifikimi

3.1 Instrumentet me një diapazon peshimi

Instrumentet e pajisura me një pajisje treguese ndihmëse i përkasin klasës I ose klasës II. Për këto dy klasa instrumentesh, kufijtë e poshtëm të kapacitetit minimal merren nga tabela 1, duke zëvendësuar të kolona e tretë ndarjen verifikuese të shkallës “e” me ndarjen reale të shkallës “d”.

N.q.s. $d < 10^{-4} \text{ g}$, kapaciteti maksimal i klasës I mund të jetë më i vogël se 50000 e.

3.2 Instrumentet me shumë diapazone peshimi

Lejohen shumë diapazone peshimi, me kusht që ato të tregohen qartësisht mbi instrument. Çdo diapazon individual peshimi klasifikohet sipas nënplikës 4.3.1. Nëse diapazonet e peshimit u takojnë klasave të ndryshme të saktësisë, instrumenti duhet të veprojë në përputhje me

kërkesat më të forta që zbatohen për klasat e saktësisë në të cilën përfshihen diapazonet e peshimit.

3.3 Instrumentet me shumë intervale

3.3.1 Instrumentet me një diapazon të peshimit mund të kenë disa variacione të pjesshme të peshimit (instrumentet me shumë ndërhyrje).

Instrumentet me shumë ndërhyrje nuk duhet të pajisen me një pajisje përcjellëse ndihmëse.

3.3.2 Çdo kufi i pjesshëm peshimi i instrumenteve me shumë intervale përcaktohet nga:

a) Ndarja verifikuese e shkallës së tij, e_i me $e_{(i+1)} > e_i$

b) Kapaciteti maksimal i tij, $\text{Max } i$ me $\text{Max } r = \text{Max}$

c) Kapaciteti minimal i tij, $\text{Min } I$ me $\text{Min } i = \text{Max}(i-1)$ dhe $\text{Min } 1 = \text{Min}$

ku:

$$i = 1, 2, \dots, r$$

i = numri i kufirit të pjesshëm të peshimit

r = numri i përgjithshëm i kufijve të pjesshëm të peshimit

Të gjitha kapacitetet janë kapacitete të ngarkesës neto, pavarësisht nga vlera e ndonjë tare të përdorur.

3.3.3 Shkallët e pjesshme të peshimit klasifikohen sipas tabelës 2.

Të gjithë kufijtë e pjesshëm të peshimit, duhet të jenë brenda së njëjtës klasë saktësie; kjo klasë është klasa e saktësisë së instrumentit.

Tabela 2

Instrumentet me shumë intervale				
$i = 1, 2, \dots, r$				
i = numri i diapazonit të pjesshëm të peshimit				
r = numri i përgjithshëm i diapazoneve të pjesshme të peshimit				
Klasa	Intervali i shkallës së verifikimit (e)	Kapaciteti minimal (min)	Numri i intervaleve të shkallës së verifikimit	
		Vlera minimale	Vlera minimale ⁽²⁾ $n = ((\text{Max}_i) / (e_{(i+1)}))$	Vlera maksimale $n = ((\text{Max}_i) / (e_i))$
I	$0.001 \text{ g} \leq e_i$	$100 e_i$	50 000	—
II	$0.001 \text{ g} \leq e_i \leq 0.05 \text{ g}$	$20 e_i$	5 000	100 000
	$0.1 \text{ g} \leq e_i$	$50 e_i$	5 000	100 000
III	$0.1 \text{ g} \leq e_i$	$20 e_i$	500	10 000
III	$5 \text{ g} \leq e_i$	$10 e_i$	50	1 000



Saktësia

4.1 Me zbatimin e procedurave të dhëna në pikën 3, të kësaj Rregulloreje, gabimi i tregimit nuk e kalon gabimin më të madh të lejuar, siç tregohet në tabelën 3. Në rastin e tregimit shifror gabimi në tregim korrigjohet për gabimin e rumbullakuar.

Gabimi më i madh i lejuar zbatohet për vlerën neto dhe vlerën e tares dhe për gjithë ngarkesat e mundshme, duke përjashtuar vlerat e paravendosura të tares.

Tabela 3

Gabimet më të mëdha të lejuara				
Ngarkesa				Gabimi më i madh i lejuar
Klasa I	Klasa II	Klasa III	Klasa IIII	
$0 \leq m \leq 50\,000\text{ e}$	$0 \leq m \leq 5\,000\text{ e}$	$0 \leq m \leq 500\text{ e}$	$0 \leq m \leq 50\text{ e}$	$\pm 0,5\text{ e}$
$50\,000\text{ e} < m \leq 200\,000\text{ e}$	$5\,000\text{ e} < m \leq 20\,000\text{ e}$	$500\text{ e} < m \leq 2\,000\text{ e}$	$50\text{ e} < m \leq 200\text{ e}$	$\pm 1,0\text{ e}$
$200\,000\text{ e} < m$	$20\,000\text{ e} < m \leq 100\,000\text{ e}$	$2\,000\text{ e} < m \leq 10\,000\text{ e}$	$200\text{ e} < m \leq 1000\text{ e}$	$\pm 1,5\text{ e}$

4.2 Gabimet më të mëdha të lejuara në shërbim janë dy herë më të mëdha se ato të dhëna në pikën 4.

5. Rezultatet e peshimit të një instrumenti duhet të jenë të ripërsëritshme, dhe të riprodhueshme nga përdorimi i një tjetër pajisje treguese dhe në përputhje me metodat e tjera të përdorura të balancimit.

6. Instrumenti duhet të reagojë ndaj ndryshimeve të vogla të ngarkesës.

7. Madhësitë influencuese dhe koha

7.1 Instrumentet e klasave II, III dhe IIII, që mund të përdoren në një pozicion të anuluar, duhet të jenë mjaft të pandjeshëm ndaj shkallës së ankorimit që mund të ndodhë në përdorim normal.

7.2 Instrumentet duhet të plotësojnë kërkesat metrologjike brenda kufirit të temperaturës të dhëna nga fabrikuesi. Vlera e këtij kufiri është të paktën e barabartë me:

- 5 °C për një instrument të klasës së I;
- 15 °C për një instrument të klasës së II;
- 30 °C për një instrument të klasës së III ose IIII.

Në mungesë të specifikimeve të fabrikuesit zbatohet kufiri i temperaturës prej -10 °C deri në + 40 °C.

7.3 Instrumentet që punojnë me ushqim nga rrjeti elektrik duhet të plotësojnë kërkesat metrologjike nën konditat e rrjetit elektrik brenda kufijve të luhatjeve normale.

Instrumentet që punojnë me bateri duhet të tregojnë kurdoherë, kur tensioni zbret poshtë vlerës minimale të kërkuar dhe nën këto rrethana, se ato vazhdojnë të punojnë me saktësi, ose automatikisht dalin jashtë shërbimit.

7.4 Instrumentet elektronike, me përjashtim të klasës I dhe në klasën II nëse është më pak se 1 g, duhet të plotësojnë kërkesat metrologjike nën kushte të një lagështire relative të lartë dhe në kufirin e sipërm të diapazonit të temperaturës së tyre.

7.5 Ngarkimi i një instrumenti të klasës II, III ose IIII për një periudhë kohe të zgjatur duhet të ketë një influencë të parëndësishme në tregimin e ngarkesës ose në tregimin e zeros, menjëherë sapo hiqet ngarkesa.

7.6 Nën kondita të tjera instrumentet ose do të vazhdojnë të funksionojnë në Rregullore ose të dalin automatikisht jashtë veprimi.

Projektimi dhe konstruksioni

8. Kërkesat e përgjithshme

8.1 Projektimi dhe konstruksioni i instrumenteve duhet të jetë i tillë që ato të ruajnë cilësitë e tyre metrologjike kur instalohen dhe përdoren siç duhet dhe kur përdoren në një ambient për të cilin ato janë parashikuar. Vlera e masës duhet të tregohet.

8.2 Kur ekspozohen ndaj rregullimeve, instrumentet elektronike nuk duhet të shfaqin pasoja të gabimeve domethënëse ose automatikisht t'i zbulojnë dhe tregojnë ato. Me zbulimin e një gabimi të rëndësishëm, instrumentet elektronike duhet të lëshojnë një alarm akustik ose të dukshëm, i cili vazhdon deri kur përdoruesi ndërmerr një veprim korrigjues ose gabimi të zhduket.

8.3 Kërkesat e pikave 8.1 dhe 8.2 duhet të plotësohen mbi baza të qëndrueshme gjatë një periudhe kohe që është normale nga pikëpamja e parashikimit të përdorimit të këtyre instrumenteve.

Pajisjet digjitale elektronike gjithmonë duhet të ushtrojnë kontroll të përshtatshëm të funksionimit



korrekt të procesit të matjes, të pajisjes indikative dhe të të gjithë ruajtjes së të dhënave dhe transferimit të të dhënave.

Me zbulimin automatik të një gabimi domethënës të qëndrueshmërisë, instrumentet elektronike duhet të sigurojnë një alarm vizual ose zanor që do të vazhdojë deri sa përdoruesi të ndërmarrë veprime korigjuese ose gabimi të zhduket.

8.4 Kur pajisja e jashtme është lidhur me një instrument elektronik nëpërmjet një bashkimi të përshtatshëm, cilësitë metrologjike të instrumentit nuk duhet të përkeqësohen.

8.5 Instrumentet nuk duhet të kenë karakteristika të tilla që lehtësojnë përdorimin mashtrues, ndërsa mundësitë për keqpërdorim të paqëllimshëm duhet të jenë minimale. Komponentët, të cilët nuk duhet të montohen ose të rregullohen nga përdoruesi, duhet të jenë të siguruara ndaj veprimeve të tilla.

8.6 Instrumentet duhet të projektohen që të lejojnë që të kryhen lehtësisht kontrollet ligjore të dhëna në këtë Rregull.

9. Tregimi i rezultateve të peshimit dhe vlerave të tjera të peshës

Treguesit e rezultateve të peshimit dhe vlerave të tjera të peshës duhet të jenë të saktë, të qartë dhe jo të keqinterpretueshëm dhe pajisja treguese në kushte normale përdorimi duhet të lejojë leximin e lehtë të tregimit.

Emrat dhe simbolet e njësive të referuara në pikën 1, të kësaj Shtojce, duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Direktivës 80/181/KEE, me shtimin e simbolit për karatin metrik, “ct”.

Tregimi nuk duhet të mundësohet mbi kapacitetin maksimal (max), të rritur me 9e.

Një pajisje ndihmëse e tregimit lejohet të tregojë vetëm presjen dhjetore. Një pajisje tregimi mund të përdoret vetëm përkohësisht, ndërsa printimi bëhet i papërdorshëm gjatë funksionimit të saj.

Tregimet dytësore mund të shfaqen, por me kushtin që ato të mos ngatërrohen me tregimet fillestare.

10. Printimi i rezultateve të peshimit dhe vlerave të tjera të peshës

Rezultatet e printuara duhet të jenë të sakta, lehtësisht të identifikueshme dhe të qarta. Printimi

duhet të jetë i qartë, i lexueshëm, i paheqshëm dhe i qëndrueshëm.

11. Nivelim

Kur është e nevojshme, instrumentet duhet të pajisen me një mekanizëm nivelimi dhe një tregues të nivelit, të cilët të jenë me ndjeshmëri të mjaftueshme për të lejuar instalimin e duhur.

12. Zerimi

Instrumentet duhet të pajisen me pajisje me mekanizmat e zerimit. Funksionimi i këtyre mekanizmave të mundësojë zerimin dhe të mos shkaktojë rezultate të gabuara matëse.

13. Mekanizmat e tares dhe mekanizmat e paravendosjes së tares

Instrumentet mund të kenë një ose më shumë mekanizma tare dhe mekanizma për paravendosjen e tares. Veprimi i mekanizmave së tares duhet të mundësojë zerimin e saktë dhe të sigurojë peshimin neto të saktë. Veprimi i mekanizmit të paravendosjes së tares duhet të sigurojnë përcaktimin e saktë të vlerës neto të llogaritur.

14. Instrumentet për shitje direkte në publik me kapacitet maksimal jo më të madh se sa 100 kg; kërkesa plotësuese

Instrumentet për shitje direkte në publik duhet të tregojnë të gjithë informacionin thelbësor rreth veprimit të peshimit dhe, në rastin e instrumenteve me tregues çmimi, të tregojnë qartësisht për konsumatorin vlerën e llogaritur të produktit që blihet.

Vlera që paguhet nëse tregohet, duhet të jetë e saktë.

Instrumentet me llogaritje çmimi duhet të shfaqin tregimet thelbësore për një kohë të mjaftueshme, me qëllim që blerësi t'i lexojë ato me lehtësi.

Instrumentet me llogaritje çmimi mund të kryejnë funksione të tjera nga ato të peshimit të artikujve dhe të llogaritjes së çmimit vetëm në ato raste, kur të gjitha tregimet në lidhje me këto veprime për blerësin janë të printuara qartë dhe të rregulluara përshtatshëm në faturë ose në etiketë.

Instrumentet nuk duhet të kenë karakteristika që mund të shkaktojnë direkt ose indirekt tregime, interpretimi i të cilave është i vështirë ose jo i drejtpërdrejtë.

Instrumentet duhet të mbrojnë konsumatorin kundrejt transaksioneve dhe shitjeve jokorrekte që



mund të ndodhin për shkak të funksionimit jo të mirë të tyre.

Nuk lejohen pajisjet treguese ndihmëse dhe pajisjet e tregimit të zgjeruar.

Pajisje shtesë lejohen vetëm nëse ato nuk çojnë në përdorim mashtrimi.

Instrumentet e ngjashme me ato që përdoren normalisht për shitje direkte në publik, të cilat nuk plotësojnë kërkesat e kësaj nënpike, duhet të mbajnë afër treguesit markimin e paheqshëm “i papërdorshëm për shitje direkte në publik”.

15. Instrumentet me tregim të çmimit

Instrumentet me tregim të çmimit duhet të plotësojnë kërkesat e instrumenteve me tregim të çmimit për shitje direkt në publik, për aq kohë sa ato zbatohen për instrumentin në fjalë. Printimi i një tregimi të çmimit nuk duhet të mundësohet poshtë një kapaciteti minimal.

SHTOJCA II PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

1. Moduli B: Ekzaminimi i tipit të BE-së

1.1 Ekzaminimi i tipit EU është pjesë e një procedure vlerësimi të konformitetit në të cilën një organ shqyrton dizajnin teknik të një instrumenti dhe verifikon dhe vërteton se dizajni teknik i instrumentit plotëson kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për të.

1.2 Ekzaminimi i tipit EU mund të kryhet në cilëndo nga mënyrat e mëposhtme:

- ekzaminimi i një mostre, përfaqësuesi i prodhimit të parashikuar, i instrumentit të plotë (tipi i prodhimit);

2. Emri dhe adresa e prodhuesit dhe, kur është e mundur, përfaqësuesi i tij i autorizuar.

3. Kjo deklaratë e konformitetit lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit.

4. Objekti i deklaratës (identifikimi i instrumentit që lejon gjurmueshmërinë, mundet, aty ku është e nevojshme për identifikimin e instrumentit, të përfshijë një imazh):

5. Objekti i deklaratës së përshkruar më sipër është në përputhje me legjislacionin përkatës të harmonizimit të Bashkimit.

6. Referencat për standardet përkatëse të harmonizuara të përdorura ose referencat ndaj specifikimeve të tjera teknike në lidhje me të cilat konformiteti është deklaruar.

7. Organi ... (emri, numri) kryen ... (përshkrimi i ndërhyrjes) dhe lëshoi certifikatën.

8. Informacione shtesë:

Nënshkruar për dhe në emër të:

(vendi dhe data e lëshimit):

(emri, funksioni) (nënshkrimi):

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar (dhe dokumenti i referencës)	Titulli i standardit në shqip	Viti i adaptimit si SSH-së	Mënyra e adaptimit (me faqe të parë FP ose me përkthim të plotë PP)
1	EN 45501:2015 Metrological aspects of non-automatic weighing instruments	SSH EN 45501:2015 Aspekte të metrologjisë për instrumentet peshuese joautomatike	2015	FP



URDHËR

Nr. 524, datë 23.9.2019

**PËR AUTORIZIMIN E “NOVAL
LABORATORY” PËR KRYERJEN E
ANALIZAVE LABORATORIKE TË
MOSTRAVE TË MARRA GJATË
KONTROLLIT ZYRTAR DHE TIPIN E
ANALIZAVE QË ËSHTË I AUTORIZUAR
TË KRYEJË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 44, pika 1 dhe nenit 59, pikat 1 dhe 9, shkronja “a”, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimin e “Noval Laboratory”, me NIPT: L81904506I, si laborator të autorizuar për kryerjen e analizave laboratorike të mostrave të marra gjatë kontrollit zyrtar, për llojin e analizave, sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij urdhri, deri më datë 25.11.2022.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

SHTOJCA I

PRODUKTI	LLOJI I ANALIZËS	TEKNIKA E PROVËS
Vajra	Përcaktimi i aciditetit	Titullim
	Numri i peroksive	
	Delta K	
Ushqime: fruta të thata	Numërim i maja dhe myqe	Numërim në pjatë
Ushqime me bazë brumi dhe nënprodukte të saj	Numërim i maja dhe myqe	Numërim në pjatë
Ushqim gati për konsum human	Numërim i kolonive bakteriale në 30°C	Numërim në pjatë
Ushqime: fruta dhe perime të freskëta	Numërim i Escherichia Coli, beta-glukoronidasi pozitive	Numërim në pjatë
Ushqime me bazë mish dhe nënproduktet e saj	Numërim i Escherichia Coli, beta-glukoronidasi pozitive	Numërim në pjatë
Ushqime me bazë veze dhe nënprodukte të saj	Kërkimi i Salmonella spp	Kërkim në pjatë
Ushqime të përpunuara gati për konsum human	Kërkimi i Listeria monocytogenes	Kërkim në pjatë

URDHËR

Nr. 536, datë 27.9.2019

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
MENAXHIMIT TË NGJALËS
EVROPIANE (*ANGUILLA ANGUILLA*)
NË SHQIPËRI PËR PERIU DHËN
2019–2024**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 25, të ligjit nr.64, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit të menaxhimit të ngjalës evropiane (*anguilla anguilla*), për periudhën 2019–2024, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

PLANI I MENAXHIMIT TË NGJALËS (*Anguilla anguilla*)

Tiranë, më 30.9.2019

HYRJE

Ngjala evropiane klasifikohet që nga viti 2009 si një “specie e rrezikuar në mënyrë kritike të zhdukjes” bazuar në opinionin e ICES (Këshilli Ndërkombëtar për Eksplorimin e Detit), i cili që në vitet 2000 konsideroi se kufijtë e sigurisë biologjike për këtë stok ishin tejkaluar. Bashkimi Evropian me miratimin e Rregullores së KE-së 1100/2007, ka detyruar shtetet anëtare që shfrytëzojnë stokun e ngjalës që të zvogëlojnë sforcën e peshkimit me 25% dhe të hartojnë një plan menaxhimi për ngjalën. Për më tepër, që nga viti 2009 ngjala evropiane përfshihet gjithashtu në shtojcën II të Konventës së Tregtisë Ndërkombëtare për Speciet

e Rrezikuara të Faunës dhe Florës së egër (CITES), e cila ka të bëjë me speciet që nuk janë domosdoshmërisht në rrezik zhdukjeje, por për tregtimin e të cilave është planifikuar një kontroll, në mënyrë që të garantohet se ato nuk janë objekt i një shfrytëzimi të papajtueshëm me mbijetesën e tyre.

Nuk ka dyshim se të gjitha masat që miratohen në nivele të ndryshme kanë një ndikim të fortë në botën prodhuese, kryesisht në ekonominë e peshkatarëve që veprojnë në ujërat e brendshme dhe lagunat bregdetare, të cilat, duke zbatuar rregulloret e miratuara, duhet të përshtaten me



kufizimet e vendosura në drejtim të kufizimeve të periudhave të peshkimit, të pajisje dhe sasive.

Është e rëndësishme të theksohet se nëse konservimi i ngjalës është pjesë e problemit më të gjerë të menaxhimit të mjediseve ujore, gjendja e resursit nuk mundëson alternativa të tjera ndaj nevojës për të ndërhyrë urgjentisht në uljen e shkaqeve të vdekshmërisë për shkak të aktiviteteve të ndryshme njerëzore, përfshirë peshkimin. Duke pasur parasysh natyrën dhe kompleksitetin e problemit, me implikimet ekonomike që ai përfshin, është e nevojshme të përvetësohet një qasje shumëdimensionale për kërkimin e një modeli të qëndrueshëm të menaxhimit që gjithashtu merr parasysh implikimet shoqërore të lidhura me peshkimin.

Avantazhet e pritura nga kjo qasje, në shkallë kombëtare, janë përqendrimi i përpjekjeve të rimëkëmbjes të popullatave, për shembull, përmes zbatimit të planeve të ripopullimit në mjediset ku këto ndërhyrje mund të kontribuojnë në rritjen e popullsisë (në mungesë të vdekshmërisë së peshkimit ose kur kjo është e rregulluar) duke ruajtur përpjekjen aktuale të peshkimit në zona të tjera ujore ku ngjala është një nga burimet kryesore të të ardhurave për operatorët lokalë.

Ngjala evropiane (*Anguilla anguilla*) është një burim për të cilin është njohur gjerësisht nevoja për ndërhyrje dhe miratimin e masave që synojnë menaxhimin e popullatave, si dhe konservimin e saj. Në lidhje me rënien e zënieve dhe zvogëlimin e rekrutimit të vëzhguar në shkallë kontinentale, është shfaqur prej kohësh nevoja për të identifikuar një kornizë qëndrueshmërie për të gjitha aktivitetet e lidhura me shfrytëzimin e saj.

Shkalla e problemit duhet të konsiderohet në shkallën evropiane, pasi speciet përbëhen nga një stok i vetëm, individët e të cilit shpërndahen në fazën e rritjes në të gjithë kontinentin evropian, si dhe në brigjet veriore të Afrikës, për të riprodhuar më pas në të vetmin vend në detin e Sargaseve në oqeanin Atlantik. Karakteristikat e panmitisë së specieve dhe shfrytëzimi i gjerë i resursit, i cili është peshkuar në mënyra të ndryshme në rajone të ndryshme evropiane, dhe ka të bëjë edhe me fazat e të vegjëlve dhe ato para-të rriturve në sistemet e vetme hidrografike, qofshin ato liqene, laguna bregdetare apo sisteme lumenjsh, përcaktoi nevojën për një strategji transnacionale për të ruajtur stokun.

Këto konsiderata janë parakushtet e Rregullores së Këshillit 1100/2007, të 18 shtator 2007, e cila përcakton masa për rikuperimin e stokut të ngjalave evropiane. Kjo kërkonte që shtetet anëtare të BE-së të interesuara për ruajtjen e shfrytëzimit të stokut, dhe natyrisht dhe vendet e tjera Evropiane të përfshira në zënien e ngjalës, të miratojnë planet e menaxhimit të ngjalës që kanë për qëllim mbrojtjen dhe rivendosjen e stokut në nivel global.

Për këtë qëllim, ky Plan Kombëtar i Menaxhimit paraqet instrumentin që është identifikuar në nivel kombëtar, në mënyrë që edhe Shqipëria t'i bashkohet vendeve të tjera Evropiane, anëtare ose jo të BE, për shfrytëzimin e qëndrueshëm të resursit dhe të mund të marrë pjesë në procesin e rimëkëmbjes së popullatës.

Në drejtim të ruajtjes së stokut të ngjalës, objektivi kryesor këtij plani menaxhimi është lejm i një niveli të duhur të migrimit të ngjalave të argjendta nga secili pellgut lumor. Kjo duke marrë parasysh ciklin biologjik të specieve, rekrutimi natyror i të cilit varet nga emigrimi i riprodhuesve nga sistemet e vetme kontinentale në det dhe nga presionet antropogjene, përfshirë peshkimin, që kanë përcaktuar uljen drastike të biomasës totale të riprodhuesve.

Elementi kritik i këtij plani menaxhimi është të lejojë të paktën 40% të ngjalave të argjendta (faza e të rriturve që ndërmerr migrimin riprodhues) të kthehen në det, duke iu referuar kushteve të pacenuara, ose biomasës së ngjalave totale dhe emigrantëve ekzistues në zonat e ndryshme, përpara shfaqjes së ndikimeve njerëzore.

Ky plan menaxhimi është në përafrim dhe zbatim të Rregullores së Këshillit të 18 shtatorit 2007 nr. 1100/2007, që vendos masat për rindërtimin e stokut të ngjalës evropiane.

Kjo rregullore krijon një kornizë për mbrojtjen dhe përdorim të qëndrueshëm të stokut të ngjalës evropiane për specien *Anguilla anguilla* në ujërat e Bashkimit Evropian, në lagunat bregdetare, në grykëderdhjet, dhe në lumenjtë që komunikojnë me ujërat e brendshëm të shteteve anëtare që rrjedhin në detet në zonat ICES III, IV, VI, VII, VIII, IX ose në detin Mesdhe.

Shtetet anëtare të BE-së duhet të identifikojnë dhe përcaktojnë basenet individuale të lumenjve që shtrihen brenda territorit të tyre kombëtar, që përbëjnë habitate natyrore për ngjalën evropiane, të cilat mund të përfshijnë ujërat detare.

Qëllimi i çdo Plani të Menaxhimit të Ngjalës duhet të jetë reduktimi i vdekshmërisë antropogjene në mënyrë që të lejojë me probabilitet të lartë largimin në det të paktën 40% të biomasës së ngjalës së argjendtë në krahasim me vlerësimin më të mirë të largimit të saj që do të kishte ekzistuar nëse nuk kishte ndikime antropogjene në stok. Plani i Menaxhimit të Ngjalës duhet të përgatitet me qëllim të arritjes së këtij objekti në terma afatgjatë.

Miratimi i këtij plani menaxhimi për Shqipërinë është i nevojshëm për disa arsye:

1. Stoku i ngjalës në rang kombëtar është në rënie të theksuar gjatë 10-vjeçarit të fundit për çdo basen ujor

2. Ngjala evropiane është një stok i përbashkët dhe nevojitet një koordinim midis të gjitha vendeve evropiane.

3. Në kuadër të përafrimit të masave menaxhuese me Bashkimin Evropian.

Legjislacioni shqiptar parashikon si dimension minimal të zënies së ngjalës në 25 cm.

Me miratimin e planit të Menaxhimit të Ngjalës peshkimi për ngjalën e specieve *Anguilla anguilla* do të lejohet gjatë tërë vitit, me kusht që peshkimi të jetë në përputhje me specifikimet dhe kufizimet e përcaktuara në këtë Plan të Menaxhimit të Ngjalës.

KARAKTERIZIMI I MJEDISEVE UJORE TË IDENTIFIKUARA TË NGJALËS

Aktiviteti i peshkimit të ngjalës në Shqipëri kryhet në liqenin e Shkodrës dhe në lagunat bregdetare. Tetë lagunat kryesore bregdetare ndodhen në vijën bregdetare shqiptare me gjatësi prej rreth 430 km që përmban dy njësi gjeografike: zonat bregdetare të detit Adriatik dhe Jon. Shtatë prej tyre (nga veriu në jug; Viluni, Kune, Vain, Patok, Karavasta, Narta dhe Orikumi) janë vendosur në vijën bregdetare të detit Adriatik dhe

vetëm një (laguna e Butrintit) ndodhet në vijën bregdetare të detit Jon.

Të dy detet kanë karakteristika mjaft të dallueshme fizike dhe kimike: Deti Adriatik tregon ndryshime të mëdha sezonale në temperaturë dhe produktivitet, me nivele të lëndëve ushqyese dhe kripëra të kontrolluara kryesisht nga inputet e ujërave të ëmbla. Në vend të kësaj, deti Jon ka një oqeanografi fizike dhe kimike më uniforme gjatë gjithë vitit.

Komuniteti i peshqve i lagunave bregdetare shqiptare është tipike për lagunat mesdhetare me dy grupe specie: peshku migrator dhe peshqit që qëndrojnë në laguna. *Sparidae*, *Mugilidae*, *Moronidae*, *Soleidae*, *Anguillidae*, *Belonidae* janë grupet kryesore të specieve migratore dhe *Gobiidae*, *Cyprinodontidae*, *Atherinidae*, *Syngnathidae* janë grupet kryesore me speciet që qëndrojnë në laguna, megjithëse disa lloje të këtyre grupeve janë gjithashtu migratore. Siç përshkruhet për secilën lagunë (shiko tabelën e specieve kryesore të peshkut për secilën lagunë), ekzistojnë disa dallime në speciet e peshkut, dhe speciet kryesore të peshkut janë: *Sparus auratus*, *Mugil spp* (*Mugil cephalus*, *M. ramada*, *M. saliens*, *Chelon Labrosus*), *Anguilla anguilla*, *Dicentrarchus labrax*, *Solea vulgaris*, *Atherina boyeri*, *Syngnathus spp*.

Në këto kategori ujore përdoren llojet e ndryshme të mjeteve të peshkimit si: pinarët për kapjen e të gjitha llojeve të peshkut, veçanërisht për ngjallat; mrezhat dhe njëcat për qefujt, kocen dhe levrekun dhe grepat për ngjallat dhe kurthet për qefujt. Në kanalet e komunikimit të tyre me detin peshkimi praktikohet peshkimi me dajlan i vendosur në kanalin që lidh lagunën ose liqenin me detin.

Peshkimi në lagunat bregdetare kryhet nëpërmjet parancave, të cilat të vendosura në rresht njëra pas tjetrës krijojnë pinarët.




Figura 1. Parancat




Figura 2. Zonat e aktivitetit të peshimit të ngjës





LIQENI I SHKODRËS

Liqeni i Shkodrës ndodhet në pjesën perëndimore të Ballkanit, në kufi midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, ndërmjet 42°21'54" dhe 19°09'52" në veri (Malo Blato, Sinjac), 42°03'15" dhe 19°30'00" në jug (burimi i Bunës), 42°03'15" dhe 19°30'00" në lindje (afër Shkodrës), 42°21'19" dhe 19°01'28" (afër Rijeka Crnojevisa). Pellgu ujëmbledhës i liqenit të Shkodrës ka një sipërfaqe prej 5179 km², nga të cilat 1027 km² janë pjesë e territorit Shqiptar.

Liqeni i Shkodrës ndahet midis Shqipërisë (1/3) dhe Malit të Zi (2/3). Ai është relativisht i cekët, me thellësi mesatare 8 m, ndërsa baseni qendror arrin 45 m thellësi, ndërsa në burimet nën sipërfaqësore në Mal të Zi arrin deri në 90 m thellësi. Rreth 50 burime të tilla nën sipërfaqësore furnizojnë liqenin me ujë të pastër. Burimi kryesor i ujërave që vijnë nga sipërfaqja është lumi Moraça në Mal të Zi. Në anën lindore dhe veriore të liqenit rajonet rrethuese me pjerrësi të ulet sjellin përmbetje sezonale duke krijuar moçalishte të përhershme. Zona malazeze e liqenit dhe e moçalishteve që formon Parkun Kombëtar të liqenit të Shkodrës konsiderohet edhe qendër Ramsar. Sipërfaqja e liqenit të Shkodrës ndryshon çdo vit në vartësi nga sasia e reshjeve dhe lëviz nga 379 në 530 km².

Zonat kryesore në pellgun ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës janë fushat e Nikshiqit dhe Cetinës, ultësira e Zeta – Shkodër, lumi Moraça me degët e tij (Zeta dhe Cemi), Përroi i Thatë me degët e tij, si dhe disa zona të tjera më të vogla, si lugina e Crnojevisa dhe lugina e Rrjollit. Lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës është 770 m, që tregon se liqeni mbledh ujëra nga malet përreth. Lartësitë mbi nivelin e detit variojnë nga 5 m në ultësirën e Mbishkodrës, deri në 1490 m mbi nivelin e detit pranë burimit të Moraçës.

Zona përreth liqenit të Shkodrës përfshin një popullsi prej 500.000 banorë në Shqipëri dhe Mal të Zi. Rreth 65% e kësaj popullsie i përket Shkodrës dhe Podgoricës, ndërkohë që pjesa tjetër qyteteve të vogla si Koplik dhe Bajzë në Shqipëri, komunave të Nikshiqit, Cetinës dhe Tivarit në Mal të Zi, si dhe shumë fshatrave rreth liqenit.

Krahas Shqipërisë dhe Malit të Zi, liqeni i Shkodrës është, gjithashtu, i rëndësishëm në një aspekt më të gjerë rajonal. Ai është një rezervë e rëndësishme për biodiversitetin dhe një rrugë

migruese për shumë lloje kafshësh të rajonit. Kjo zonë përfaqëson gjithashtu vlera të veçanta në aspektin hidrologjik dhe ekologjik, duke pasur parasysh lidhjen e liqenit të Shkodrës me një rrjet të gjerë hidrologjik në Ballkan nëpërmjet lumit Drin (liqeneve të Ohrit dhe Prespës) dhe me detin Adriatik nëpërmjet lumit Buna.

Shkodra, me rreth 115 000 banorë është qyteti më i madh në bregun e liqenit, ndërsa tri fshatrat më të mëdhenj që merren me peshkim janë: Kopliku, Shiroka dhe Zogaj. Dalje e liqenit është Buna që kalon afër qytetit të Shkodrës. Rrjedhja e poshtme e Bunës shërben si kufi midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Disa specie të peshqve që tregtohen migrojnë nga deti nëpër Bunë me rrjedhje të ngadaltë duke hyrë në liqen. Aktualisht më e rëndësishmja nga këto është ngjala.

Në liqen gjenden mbi 10 lloje peshqish me një farë rëndësie menaxhimi (tabela 1) speciet kryesore janë gjuca, krap i zakonshëm dhe ngjala. Kapen, gjithashtu, sharroku dhe disa specie të tjera, por në sasi më të pakta. Gjuca lëshon vezët në prill–maj. Ajo është një specie pelagjike, që ushqehet kryesisht me zooplankton. Krap i jeton përgjatë fundit të liqenit dhe që ushqehet me invertebratë, si dhe me disa lëndë bimore, i lëshon vezët në prill–maj. Deri para viteve 90 në liqen zbatohej një plan ripopullimi m krap dhe peshqit e familjes së krapit (ballëgjere, amur etj.) por kjo veprimtari tashmë është ndërprerë.

Në pjesën malazeze të liqenit kryhen disa veprimtari të pakta të akuakulturës bazuar në prodhimin e troftës ylber (*Onchorhynchus mykiss*) në rezervate me rrjeta. Deri tani në shumë pak raste mund të kenë shpëtuar trofta dhe të kenë hyrë në liqen. Ekzistenca e kësaj forme të akuakulturës përbën një farë shqetësimi, megjithëse këto specie mund të mos jenë në gjendje të shtohen në liqen. Liqeni i Shkodrës nuk ka habitatin (mjedisin) e përshtatshëm për salmonidet. Salmonidet e liqenit (*Salmo marmoratus*) që gjendeshin më parë në liqen, lëshonin vezët e tyre në lumenjtë që derdheshin në liqen, të cilët nga rregullimi i ujërave dhe nga ndotja janë bërë të papërshtatshëm. Kjo specie tashmë është shumë e rrallë. Megjithatë gjatë vitit 2014, janë identifikuar të vegjël të troftës së liqenit në zonën malazeze, në derdhjen e lumit Moraca në liqen. Ky përbën një lajm të mirë për liqenin dhe statusin e zonës.

Ka informacione mbi prezencën e luciperkës (*Stizostedion lucioperca*), i cili mendohet se ka hyrë në liqen përmes ujëmbledhësit të Vaut të Dejës nëpërmjet Komanit nga liqeni i Fierzës. Në qoftë se ky informacion konfirmohet dhe kjo specie grabitqare është vendosur në liqen, ekosistemi i liqenit të Shkodrës do të pësojë ndryshime të mëdha pasi kjo specie shfrytëzon gjuhçën për ushqim.



Figura 3: Shtrirja e liqenit të Shkodrës

Disa specie katodrome (*catadromous*) (d.m.th. që migrojnë nga deti drejt ujërave të ëmbla) tradicionalisht hyjnë në liqen nëpërmjet Bunës për të lëshuar vezët ose për ushqim. Bllokimi i lumit nga mjete peshkimi apo bllokimi i rrjedhjes të lumit me punime infrastrukture apo veprimtari të tjera të njeriut, si dhe nga ndotja, kanë pakësuar shumë këto specie në liqen. Kështu ngjalla hyn në lumë dhe në liqen në formën e rasateve (qelqoreve) të vogla dhe kapet nga peshkimi kur kthehet e rritur në det. Prandaj pak ndikojnë instrumentet e peshkimit që përqendrohen në peshkun që migron në ngjitje në grykën e lumit.

Lumi Buna

Lumi i Bunës rrjedh nga liqeni i Shkodrës në pjesën jugperëndimore të tij. Ka një gjatësi prej 44 km dhe është i vetmi lum fushor dhe emisari i

liqenit nga ku buron. Buna bashkohet me lumin Drin rreth 1.5 km pasi del nga liqeni dhe që nga fshati Samrisht shërben si kufi shtetëror me Malin e Zi. Prurjet shumëvjeçare të Bunës në dalje nga liqeni i Shkodrës janë 320 m³/sek dhe mbasi bashkohet me lumin Drin ato arrijnë vlerën 680 m³/sek. Lumi i Bunës ka arritur nivel maksimal të plotave prej 7500 m³/sek duke përmbytur sipërfaqe të mëdha toke. Në dekadat e fundit në pakësimin e përmbytjeve dhe të pasojave të tyre luajnë rol tri digat e hidrocentraleve të ndërtuara në lumin Drin. Derdhja e lumit Drin shpesh herë pengon shkarkimin e ujërave të liqenit të Shkodrës, si dhe ndonjë herë shfaqet dukuria e rrjedhjes me drejtim kundërt e lumit të Bunës. Për shkak të pjerrësisë së vogël dhe prurjeve të ngurta të Drinit shtrati i Bunës ka ndryshuar shpesh duke formuar



meandre. Buna në det përfundon me një deltë natyrale që është e përbërë nga disa ishuj aluvionalë, si ishulli i Adës, Franc Jozefi etj. Lumi i Bunës në dalje të liqenit të Shkodrës ka një pellg ujëmbledhës prej 5187 km², ndërsa kur bashkohet me lumin Drin ka një sipërfaqe prej 19582 km².

Liqeni i Shkodrës luan një rol të rëndësishëm në regjimin e Bunës duke shërbyer si rregullator i prurjeve të saj. Kjo e bën një nga lumenjtë me regjim relativisht më të rregullt të Shqipërisë, prurjet e së cilit pësojnë luhatjet më të vogla në krahasim me gjithë lumenjtë e tjerë të mëdhenj të Shqipërisë.

Në lumin Buna gjenden mbi 30 lloje peshqish të ujërave të ëmbla ndër të cilët përmendim krapin (*Cyprinus carpio*), karasin (*Carassius auratus*), gjuhçen (*Alburnus alburnus alborella*), njilën (*Chondrostoma nasus ohridanus*), skortin e zi (*Pachychilon pictum*), lloshkën (*Scardinius erythrophthalmus scardafra*), mlyshin (*Leuciscus cephalus albus*), sharmakun (*Perca fluviatilis*), barburin (*Bleinius fluviatilis*) etj. Lumi është rrugë kalimi i peshqve të cilët migrojnë nga deti në liqenin e Shkodrës e anasjelltas. Janë 13 lloje peshqish migratorë nga të cilët përmendim blini (*Acipenser sturio*) që është lloj i rrezikuar globalisht, kublën (*Allosa fallax nilotica*), ngjala (*Anguilla anguilla*), levreku (*Dicentrarchus labrax*), qefullin e verës (*Mugil cephalus*), qefullin e vjeshtës (*Liza ramada*), shojzën (*Platichthys flesus luscus*) etj. Në grykëderdhjen e Bunës ka mbi 50 lloje të tjerë peshqish ku përmendim açugën (*Engraulis encrasicolus*), çeliku (*Aphianus fasciatus*), gjilpërëza turi gjatë (*Syngnathus tenuirostris*), korbi i zi (*Sciaena umbra*), korbi i bardhë (*Umbrina cirrosa*), sargoji (*Diplodus sargus sargus*), murra (*Lithognathus mormyrus*) aterina (*Atherina hesperus*), gjuhëza e Adriatikut (*Solea vulgaris*) etj.

Buna është e pasur me lloje të ndryshme shpendësh ku janë numëruar rreth 50 lloje shpendësh dhe bën pjesë në një nga tri rrugët e migrimit të shpendëve të Evropës. Një pjesë e llojeve të shpendëve që vëzhgohen janë migratore dhe folezues në këtë zonë. Ndër to përmendim ato lloje që kanë numrin më të madh të individëve si kredharaku i vogël (*Tachybaptus ruficollis*), karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmaeus*), kryekuqja e madhe (*Anas penelope*), rosa e vendit (*Anas platyrhynchos*), rosa sqeplugë (*Anas clypeata*), rosa kërre (*Anas crecca*), kryekuqja e mjerme (*Aythya ferina*), rosa me katër sy (*Bucephala clangula*), bajza

(*Fulica atra*), cinja (*Vanellus vanellus*), pulëbardha e zakonshme (*Larus ridibunda*), pulëbardha e vogël (*Larus minutus*), dallëndyshja e detit (*Sterna sandvicensis*), laraska e detit (*Haematopus ostralegus*), gielaci symadh (*Burhinus oedicnemus*), kalorësi (*Himantopus himantopus*), sqep biza (*Recurvirostra avosetta*), bisht dallëndyshja (*Glareola pranticola*), vrapuesi gushëbardhë (*Charadrius alexandrinus*), dallëndyshja e vogël e detit (*Sterna hirundo*) etj.

STATUSI MJEDISOR I ZONËS

Në Malin e Zi që nga viti 1983 liqeni i Shkodrës është shpallur Park Kombëtar (kategoria e dytë e menaxhimit sipas IUCN). Në vitin 1995 Parku Kombëtar i liqenit të Shkodrës u shpall zonë Ramsar (sipërfaqe ligatinore e rëndësishme së veçantë). Parku kombëtar ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 40.000 ha.

Në Shqipëri statusi aktual i mbrojtjes së liqenit të Shkodrës është “Rezervat Natyror i Menaxhuar” (kategoria IV sipas IUCN), shpallur nga qeveria shqiptare me vendim nr. 684, datë 2.11.2005.

Rezervati natyror i menaxhuar i liqenit të Shkodrës, kufizohet:

Nga veriu: me pikën kufitare “Hani i Hotit” (42° 20'17" 19° 26');;

Nga perëndimi: me kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Mali të Zi;

Nga lindja: me rrugën kombëtare automobilistike Shkodër–Hani i Hotit;

Nga jugu: me vijën që bashkon grykëderdhjen e liqenit të Shkodrës me pikën kufitare (koordinatat: 42° 04'18" 19° 23', 42° 03'08" 19° 29'30").

3. Rezervati natyror i menaxhuar i liqenit të Shkodrës ka një sipërfaqe të përgjithshme 26 535 ha, të përbërë nga:

- sipërfaqe ujore 15 719 ha;
- sipërfaqe pyjore e shkurre 1965 ha;
- të tjera 8851 ha.

Zona e mbrojtur në pjesën shqiptare ndahet në tri kategori:

a) Zona qendrore (e paraqitur në hartën që i bashkëlidhet Vendimit me 1/a) e përbërë nga: bregu i liqenit, që fillon nga pika ekstreme perëndimore e fshatit Zogaj deri në kufirin midis dy Republikave, Shqipëri–Mal i Zi, shpati i Malit Tarabosh nga lartësia 494 m në jug, deri në 200 m në brendësi të ujërave të liqenit në segmentin ndërkufitar Zogaj–Shqipëri–Mal i Zi në veri. Në këtë zonë aplikohet niveli i dytë i mbrojtjes.



b) Zonë e habitateve të menaxhuara (e paraqitur në hartën që i bashkëlidhet vendimit me 2/a) e përbërë nga: gjithë sipërfaqja ujore e liqenit, përjashtuar zona e përfshirë në 1/a e përmendur më sipër; bregu perëndimor shqiptar nga ura e Bunës në lindje, në fshatin Zogaj në perëndim (duke rrethuar zonën 1/a të kësaj pike) duke përfshirë gjithë lartësitë e këtij segmenti deri në 300 m në shpatin e Malit Tarabosh në jug. Në këtë zone aplikohet niveli i tretë i mbrojtjes.

c) Zonë e zhvillimit tradicional (e paraqitur në hartën që i bashkëlidhet vendimit me 3/a) e përbërë nga: e gjithë sipërfaqja lindore e liqenit, kufizuar në perëndim me zonën 2/a të përmendur më sipër, deri në rrugën Shkodër–Hani i Hotit në lindje dhe qytetin e Shkodrës në fundin juglindor. Në këtë zonë aplikohet niveli i katërt i mbrojtjes.

Zona liqenore në pjesën shqiptare është shpallur edhe zonë Ramsar (Konventa e Ramsarit “Ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate për shpendët ujore”) me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 2.11.2005.

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në liqenin e Shkodrës zhvillon aktivitetin e saj Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), liqeni i Shkodrës. OMP-ja liqeni i Shkodrës është ngritur me urdhrin e MBU-së nr. 17/2, datë

21.5.2003 “Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP-ja liqeni i Shkodrës)”. Me njohjen e OMP-së liqeni i Shkodrës, ky liqen ka marrë statusin e zonës së bashkëmenaxhimit. OMP-ja liqeni i Shkodrës është themeluar më 23 mars 2003, dhe ministri miratoi statusin ligjor të kësaj organizate më 21 maj 2003. Në pjesën shqiptare të liqenit të Shkodrës është edhe dajlani i Shkodrës, i cili ka një status të dyfishtë. Kjo organizatë është e pajisur me kontratë për ushtrimin e aktivitetit në fushën e peshkimit me nr. 6042, të prot. datë 2.8.2016, me afat 10-vjeçar, bazuar në VKM-në nr. 469, datë 22.6.2016 “Për shpalljen e liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna si zonë bashkëmenaxhuese peshkimi”. OMP-të janë organizata me struktura private ligjore të pavarura, janë jofitimprurëse dhe të gjithë të ardhurat e saj përdoren për funksionimin e organizatës dhe për përmbushjen e objektivave të saj. OMP-ja merr pjesë aktive në menaxhimin e liqenit, kjo dhe për faktin se lejet e peshkimit i lëshohen vetëm anëtarëve të OMP-së.

Gjuetia e ngjales në këtë zonë kryhet nëpërmjet peshkimit artizanal me paranca (me rreth 25 paranca) dhe me rreth 1000 grepa (nga 50 grupe peshkimi).

Tabela 1. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të liqenit të Shkodrës dhe përqindjet e zënies së tyre

Speciet	Emri shqip	Emri shkencor	Përqindja
Emri anglisht			
Speciet e liqenit			
Bleak	Gjuca, Ciron	Alburnus albidus alborella	21.73%
Common carp	Krap	Cyprinus carpio	27.86%
Crucian carp	Karasi	Carassius	10.72%
Roach	Gurnec	Rutilus rubilio	32.31%
Mullet	Qefulli	Mugil cephalus	5.23%
European eel	Ngjala	Anguilla	1.17%
Alosa	Kubla	Alosa fallax	0.27%
Perch	Sharroku	Perca fluviatilis	0.72%
Sturgeon	Blini	Acipenser sturio	0%

Burimi: OMP-ja liqeni i Shkodrës, 2009–2019



Tabela 2. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite (burimi: OMP-ja liqeni i Shkodrës)

Viti	Zëniet sipas formës së peshkimit (ton)/ numri i mjeteve të peshkimit			Prodhimi total vjetor (ton)	Prodhimi në % sipas peshës së ngjalës (g)		
	Dajlan	Mjete fikse			80-100 g	100-300 g	Mbi 300 g
		Paranca	Grepa				
		(25 paranca)	(50 subjekte me 1000 grepa)				
2013	1.4	3.7	0.4	5.5	5%	20%	75%
2014	1.4	3	1.1	5.5	3%	25%	72%
2015	0.8	N/A	N/A	0.8	-	20%	80%
2016	1	3	N/A	4	5%	20%	75%
2017	7.5	10	4	21.5	5%	20%	75%
2018	6	6.5	5	17.5	5%	20%	75%

LAGUNA E VILUNIT

Laguna e Vilunit. Laguna e Vilunit ndodhet në veri të Shqipërisë, 7 km në jug të grykës së lumit Buna dhe 10 km në veriperëndim të portit të Shëngjinit. Kufijtë e saj janë si më poshtë: në veri është fshati Velipojë, në lindje është fshati Bakshi i Ri, në jug është fshati Rrjoll dhe në perëndim është deti Adriatik.

Sipërfaqja (ha)	Gjatësia max (m)	Gjerësia max (m)	Thellësia max. (m)	Thellësia mesatare (m)
280	3500	2000	5	0,8

Shkëmbimi i ujit me detin bëhet përmes kanalit të hyrjes me detin 500 metra i gjatë dhe 30-40 m i gjerë. Në det, thellësia e ujit po rritet ngadalë duke arritur në izobatet 20m në 3 km nga bregu. Dy kanale kryesore kullimi sjell ujë të

pasur me lëndë ushqyese në lagunën e Vilunit nga fusha bujqësore. Kanalet e kullimit shtrihen nga zona e nën Shkodrës, duke hapur kanalin e lagunës në grykën e komunikimit me detin.

Laguna e Vilunit, si pjesë e kompleksit ligatinor të bregdetit verior shqiptar, ka origjinën e tij nga veprimtaria aluvionale e depozitimit të lumit Buna. Produktet e sedimentimit të sjella nga lumi Buna janë transportuar dhe janë vendosur në deltën e lumit Buna. Lumi Buna është mbushur intensivisht me depozita aluvionale, të cilat kanë hyrë thellë në det. Depozitat e diferencuara të aluvioneve dhe lidhjet e tyre me bregdetin me rërë masive kanë krijuar një labirint të formave të ngjashme me: shigjeta, harqe dhe shtigje ranore që kanë hyrë në det duke krijuar lagunën.

Tabela 3. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Vilunit

Emri anglisht	Emri shqip	Emri shkencor
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	Mugil cephalus
Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	Chelon labrosus
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	Liza ramada
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	Liza saliens
European seabass	Levrek	Dicentrarchus labrax
European eel	Ngjalë	Anguilla anguilla
Gilthead seabream	Koce	Sparus aurata
Bogue	Vope	Bops bops
White seabream	Sargua, Shpalcë	Diplodus sargus sargus
Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	Solea vulgaris
Mediterranean sand smelt	Aterina	Atherina hepsetus
Pipefish	Gjilpërëza	Syngnathus sp
Buccich's goby	Burdullak	Gobius bucchichi

Burimi: *Ibktiofauna e Shqipërisë* (prof. Ndoc Rakaj, Aleksandër Flloko "Libri Universitar", Tiranë 1995)



STATUSI MJEDISOR I ZONËS

Laguna e Vilunit është peizazh i mbrojtur bazuar në VKM-në nr. 682, datë 2.11.2005 “Për shpalljen e lumit Buna dhe të territoreve ligatinore përreth tij “peizazh ujor/tokësor i mbrojtur”.

Peizazhi ujor/tokësor i mbrojtur kufizohet:

Nga Veriu: Me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri në kufirin verior me Republikën Serbi-Mali i Zi (koordinatat 420 03'08" 190 29'30", 420 01'31" 190 29', 420 00'36" 190 25'7", 420 00' 190 23'45");

Nga Perëndimi: Me vijën e kufirit shtetëror përgjatë lumit Buna me Republikën Serbi-Mali i Zi;

Nga Lindja: Me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri te Rëra e Hedhur dhe që kalon nga zona malore (koordinatat: 410 50'30" 190 35'30", 420 53'15" 190 30', 410 59'30" 190 31'30", 420 00' 190 31'33", 420 02'15" 190 30', 420 03'08" 190 29').

Nga Jugu: Me vijën bregdetare nga Rëra e Hedhur deri te grykëderdhja e lumit Buna (koordinatat: 410 50'57" 190 23', 410 51'28" 190 27'30", 410 50'58" 190 30'. Peizazhi ujor/tokësor i mbrojtur i lumit Buna ka një sipërfaqe të përgjithshme 23 027 ha, të përbërë nga:

- sipërfaqe pyjore dhe shkurre, 7 799 ha;
- sipërfaqe lagunore, 346 ha;
- duna ranore, bregdetare, 496 ha;
- toka të kripura, 252 ha;
- sipërfaqe të tjera (toka bujqësore, zona të banuara), 14 134 ha.

Peizazhi ujor/tokësor i lumit Buna ka zonimin e mëposhtëm:

Zona qendrore (zona A)

A.1 Zonë qendrore e përbërë nga:

- pjesa e lumit Buna dhe brigjet e tij nga bashkimi me lumin Drin deri në fshatin Obot;
- brigjet e lumit Buna në pjesën perëndimore të rezervatit të Velipojës, nga grykëderdhja e lumit

deri përballë skajit verior të ishullit Ada dhe 200 m në brendësi të rezervatit në lindje;

c) ishulli i Franc Jozefit dhe bregdeti në lindje të grykëderdhjes, në gjatësi deri 2 km dhe gjerësi 300 m në det, drejt jugut;

d) ç) pjesa qendrore dhe veriore e lagunës së Vilunit;

e) gadishulli në plazhin e Baks–Rrjollit dhe një gjerësi 300 m në jug të vijës bregdetare deri te Rëra e Hedhur;

dh) pjesa qendrore e kënetave të Domnit dhe të Murtemzës.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”.

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në lagunën e Vilunit, ushtrohet aktivitet peshkimi artizanal lagunor me dajlan dhe me mbrezhda, njica, grepa e pinar, me 3 grupe gjuetie peshku, me barka peshkimi me motor foribord me rreth 10 peshkatarë.

Për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar 3 grupe gjuetie peshku me rreth 6 peshkatarë që ushtrojnë aktivitet peshkimi gjithëvjetor.


Këto grupe peshkimi, përdorin kryesisht rrjeta të tipit mbrezhda e njica, rreth 15–20 copë për çdo grup gjuetie (1 mrezhde/njice ka gjatësinë rreth 50–60 ml), pra do të përdoren rreth 3000–3600 ml rrjeta gjuetie. Gjithashtu, këto grupe peshkimi përdorin dhe rreth 500 grepa peshkimi.

Aktivitetin e peshkimit artizanal me dajlan e kryejnë aktualisht 2 grupe peshkimi me 1 dajlan (për periudhën 1 tetor–14 mars të çdo viti). Në dajlan punojnë 4 peshkatarë (2 turne x 2 peshkatarë).

Gjuetia e ngjalës në këtë zonë kryhet nëpërmjet peshkimit artizanal me paranca (me rreth 150 paranca).

Tabela 4. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite

Viti	Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)				Zëniet sipas dimensioneve (g)		
	Dajlan	Paranca	Grepa	Totali	80-100	100-300	>300
2013	0,89	2,90	0	3,8	35%	55%	10%
2014	0,64	2,62	0	3,3	35%	55%	10%
2015	1,30	3,30	0	4,6	35%	55%	10%
2016	0,75	2,84	0	3,6	35%	55%	10%
2017	0,60	1,70	0	2,3	35%	55%	10%
2018	0,68	2,40	0	3,1	35%	55%	10%
Totali	4,86	15,77	0	20,6			



KOMPLEKSI LAGUNOR KUNE-VAIN

Laguna e Vain ndodhet në jug të lumit Drini dhe është një nga komplekset e lagunës Kune-Vain. Ndodhet 70 km larg nga Tërrana, kryeqyteti i vendit dhe 45 km larg nga liqeni i Shkodrës, pranë kufirit me Jugosllavinë, 20 km në perëndim të qytetit të Lezhës dhe në veri të grykës së lumit Drin. Kufijtë e tij janë në veri të lumit Drin, në lindje fshatrat e ishullit Lezhë dhe Rrile, në jug kanali i rrjedhjes së ujërave të larta dhe në perëndim deti Adriatik. Sipërfaqja e lagunës është 850 ha. Përfshihet në zonën e ligatinës M2 midis paralelit 41° dhe 30'' dhe 19° dhe 30''.

Sipërfaqja (ha)	Gjatësia max (m)	Gjerësia max (m)	Thellësia max. (m)	Thellësia mesatare (m)
850	4400	2950	4,5	0,7

Laguna e Vain ka origjinën e tij nga aktivitetet tektonike dhe aktiviteti depozitues aluvional i lumenjve Drin dhe Mat. Sedimenti i imët është transportuar nga ujërat e rrjedhës dhe janë

vendosur në shtratin e detit dhe deltën e lumenjve. Delta e lumit Drin është e mbushur intensivisht me depozita aluvionale, ndërsa në veri dhe lindje kjo zonë është e rrethuar nga zona malore të larta me origjinë nga formimi Mesozoik dhe paleogjenetik. Më tej tektonika e fortë gjatë kuartenarit, veçanërisht ndryshimi i shtratit të lumenjve shkaktoi formimin e pellgjeve të lidhura në mënyrë periodike ose të përhershme me detin, duke ndryshuar kështu vazhdimisht vijën e bregdetit. Depozitat e diferencuara të aluvioneve dhe lidhjet e tyre me bregdetin me rërë masive kanë krijuar një labirint të formave të ngjashme me shigjeta, harqe dhe shtigje me rërë.

Kanali lidhës me detin është i gjatë 1800 m, rreth 30 m i gjerë dhe maksimumi i thellë 1 m. Kjo lagunë nuk ka një shkëmbim të qëndrueshëm të ujit me detin për shkak të mbylljes së grykës së kanalit të hyrjes – kanalit të detit nga depozitimi i rërës. Pusët arteziane janë gjithashtu përbërës të ekuilibrit të ujit të lagunës Vain. Ka 9 puse të tilla, që kanë shkarkimin $Q = 5-6 \text{ l/s}$.

Tabela 5. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Vainit

Emri anglisht	Emri shqip	Emri shkencor
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	Mugil cephalus
Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	Chelon labrosus
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	Liza ramada
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	Liza saliens
European seabass	Levrek	Dicentrarchus labrax
European eel	Ngjalë	Anguilla anguilla
Gilthead seabream	Koce	Sparus aurata
Bogue	Voqe	Bops bops
White seabream	Sargua, Shpalcë	Diplodus sargus sargus
Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	Solea vulgaris



Mediterranean sand smelt	Aterina	Atherina hepsetus
Pipefish	Gjilpërëza	Syngnathus sp
Buccich's goby	Burdullak	Gobius bucchichi

Burimi: Ibktofauna e Shqipërisë (Ndoc Rakaj, Aleksandër Flloko "Libri Universitar", Tiranë, 1995)

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS


Në lagunën e Vainit (me nënndarjet zona lagunore Zajë dhe zona lagunore Ceke), për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar 8 grupe gjuetie peshku me rreth 16 peshkatarë, me tetë barka peshkimi. Këto grupe peshkimi, përdorin kryesisht rrjeta të tipit mbrezhda e njica, rreth 6–10 copë për çdo grup gjuetie (1 mbrezhdë/njice ka gjatësinë rreth 50-60 ml), pra përdoren rreth 5000 ml rrjeta gjuetie.

Aktivitetin e peshkimit artizanal me dajlan e kryejnë aktualisht dy subjekte peshkimi me dy dajlanë (për periudhën 1 gusht–9 mars të çdo viti). Në dajlanin e lagunës së Cekës punojnë rreth nëntë peshkatarë, ndërsa në lagunën e Zajës mbi lumin Drin punojnë tre peshkatarë, me tri turne.

Peshkimi i ngjalës në këtë lagunë bëhet në formën e peshkimit artizanal me dajlan dhe në formën e peshkimit artizanal me paranca. Për këtë të fundit, përdoren rreth 70 paranca për kapjen e ngjalës.

Tabela 6. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite

Viti	Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)				Zëniet sipas dimensioneve (g)		
	Dajlan	Paranca	Grepa	Totali	80-100	100-300	>300
2013	3,7	4,2	0,00	7,91	35%	55%	10%
2014	3,5	3,3	0,00	6,80	35%	55%	10%
2015	3,4	4,5	0,00	7,90	35%	55%	10%
2016	4,1	4,3	0,00	8,43	35%	55%	10%
2017	3,7	1,5	0,00	5,16	35%	55%	10%
2018	6,4	5,2	0,00	11,64	35%	55%	10%
Totali	24,83	23,00	0,00	47,83			





Laguna e Kune, si pjesë e kompleksit të lagunës Kune–Vain, ndodhet në anën veriore të lumit Drin. Kufijtë e tij janë në veri të qytetit të Shëngjinit, në lindje fshatin Ishulli Shëngjini, në jug lumi Drin dhe në perëndim deti Adriatik.

Ndodhet 70 km larg nga Tirana, kryeqyteti i vendit dhe 45 km larg liqenit të Shkodrës, afër kufirit me Jugosllavinë, 20 km në perëndim të qytetit të Lezhës dhe në veri të rrjedhës së lumit Drin.

Sipërfaqja (ha)	Gjatësia max (m)	Gjerësia max (m)	Thellësia max. (m)	Thellësia mesatare (m)
250	5800	950	5	1

Sedimenti i imët është transportuar nga ujërat e rrjedhës dhe janë vendosur në shtratin e detit dhe deltën e lumenjve. Delta e lumit Drin është e mbushur intensivisht me depozita aluvionale, ndërsa në veri dhe lindje kjo zonë është e rrethuar

nga zona malore të larta me origjinë nga formimi Mesozoik dhe paleogjenetik. Më tej tektonika e fortë gjatë kuartenarit, veçanërisht ndryshimi i shtratit të lumenjve shkaktoi formimin e pellgjeve të lidhura në mënyrë periodike ose të përhershme me detin, duke ndryshuar kështu vazhdimisht vijën e bregdetit. Depozitat e diferencuara të aluvioneve dhe lidhjet e tyre me bregdetin me rërë masive kanë krijuar një labirint të formave të ngjashme me shigjeta, harqe dhe shtigje me rërë, të cilat kanë hyrë në det duke krijuar lagunën dhe ishullin (ishulli Kune).

Gryka e shkëmbimit të ujit (kanali i hyrjes – deti) është 560 m i gjatë dhe 14–20 m i gjerë dhe maksimumi 3 m i thellë dhe kjo lagunë ka një shkëmbim relativisht të qëndrueshëm të ujit. Puset arteziane (burimet) janë, gjithashtu, përbërës të bilancit të ujit të lagunës së Kune. Ka 3 puse të tilla, që kanë shkarkimin $Q = 5-6 \text{ l/s}$.

Tabela 7. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Kunës

Emri anglisht	Emri shqip	Emri shkencor
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	Mugil cephalus
Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	Chelon labrosus
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	Liza ramada
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	Liza saliens
European seabass	Levrek	Dicentrarchus labrax
European eel	Ngjalë	Anguilla anguilla
Gilthead seabream	Koce	Sparus aurata
Bogue	Voqe	Bops bops
White seabream	Sargua, Shpalcë	Diplodus sargus sargus
Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	Solea vulgaris
Mediterranean sand smelt	Aterina	Atherina hepsetus
Pipefish	Gjilpërëza	Syngnathus sp
Buccich's goby	Burdullak	Gobius buccichi

Burimi: Ibktofauna e Shqipërisë (Ndoc Rakaj, Aleksandër Flloko, "Libri Universitar", Tiranë, 1995)



STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në këtë lagunë (me nënzonat Gjoli i Knallës, Vija Kular dhe Merxhani), ushtrohet aktivitet peshkimi artizanal lagunor me dajlan, me mrezhda, njica e pinar dhe rrallë herë me grepa (rreth 500 copë), me 14 grupe gjuetie peshkimi me rreth 28 peshkatarë (nga të cilët 4 me punësim provizor).

Për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar 8 grupe gjuetie peshku me rreth 12 peshkatarë që ushtrojnë aktivitet peshkimi gjithë vjetor dhe 2 me punësim provizor.


Këto grupe peshkimi, përdorin kryesisht rrjeta të tipit mrezhda e njica, rreth 6–8 copë për çdo grup gjuetie (1 mrezhde/njica ka gjatësinë rreth 50–60 ml), pra përdoren rreth 4 000–5 000 ml rrjeta gjuetie.

